VENDIM
Nr. 468, datë 30.5.2013
(Ndryshuar me VKM nr.300, datë 8.04.2015)
(I përditësuar)

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR ZHVILLIMIN E *BROADBAND*-IT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:
(Zëvendësuar emërtimi "Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit" me "Ministri përgjegjës për komunikimet elektronikeme VKM nr.300, datë 8.04.2015".)

1. Miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e *Broadband*-it, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet *Ministri përgjegjës për komunikimet elektronike* të bashkëpunojë me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si dhe me institucionet e tjera për ndjekjen dhe zbatimin e këtij dokumenti.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLANI KOMBËTAR PËR ZHVILLIMIN E *BROADBAND*-IT
MAJ 2013

Parathënie

Duke pasur parasysh rolin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, përfshirë zhvillimin global në fushën e tregtisë, edukimit, shëndetësisë dhe shërbimeve të qeverisjes elektronike, qeveria shqiptare ka identifikuar si një prioritet të rëndësishëm zhvillimin e TIK-ut për sigurimin e një game të gjerë të shërbimeve të komunikimit elektronik dhe sigurimin e lidhjeve të besueshme dhe të përballueshme përmes këtyre shërbimeve. Gjithashtu, qeveria ka vënë në dukje se për të arritur këto sfida është thelbësore shtrirja e aksesit të shërbimeve me brez të gjerë (*broadband*) dhe shpejtësi të lartë, në të gjithë vendin.

Teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit janë thelbësore për të rritur mundësitë e zhvillimit ekonomik në të gjithë vendin, duke përfshirë veçanërisht zonat rurale, për t'i bërë këto zona sa më tërheqëse për investime dhe zhvendosje të njerëzve drejt këtyre zonave. Për sa më sipër, duke kuptuar se çfarë mund të bëjë TIK dhe *e-literatura* veçanërisht në zonat rurale dhe zonat e largëta, ka gjithmonë nevojë për përmirësime. Qeveria është e vetëdijshme se zonat rurale në mënyrë të veçantë kanë nevojë për *broadband* dhe përfitimet që ai mundëson. TIK janë, gjithashtu, thelbësore për përfshirjen e njerëzve me nevoja të veçanta.

Akoma ekzistojnë në vend, shumë zona të quajtura "zona të bardha", në të cilat nuk ofrohen shërbimet *broadband*, veçanërisht në zonat më të thella rurale. Për të nxitur shtrirjen dhe rritur ndërgjegjësimin për përfitimet nga TIK në jetën e përditshme, në punë, në edukim, tregti, në qeverisje dhe shëndetësi, si dhe për të rritur investimet në të gjithë vendin, do të përcaktohen masa të veçanta që do të kenë si objektiv zonat ku nuk ofrohet shërbim dhe zonat ku ofrohet pak shërbim, përfshirë zonat e thella rurale.

Sot, Shqipëria digjitale nuk është më një slogan, por një realitet. Për këtë arsye qeveria ka vendosur të përdorë TIK-un në të gjitha institucionet jo vetëm për punën e përditshme dhe komunikimet e brendshme të saj, por kryesisht për ofrimin e shërbimeve të drejtpërdrejta *online* për qytetarët dhe bizneset.

Qeveria shqiptare e konsideron shtrirjen e rrjeteve *broadband* si një element të rëndësishëm

për zhvillimin e ardhshëm social dhe ekonomik, por beson se pa ndërhyrjen publike, ekziston rreziku që shtrirja e rrjeteve të shpejta *broadband* të fokusohet kryesisht në zonat me densitet të lartë të popullsisë, duke përjashtuar zonat rurale dhe të largëta.

Qeveria shqiptare konstaton se Komisioni Europian ka theksuar rëndësinë që shtetet anëtare të saj të kenë një plan veprimi për zhvillimin e *broadband* me objektiva kombëtarë të përcaktuar në të njëjtën linjë me objektivat e *broadband*-it Europian, si dhe një tërësi masash politike të balancuara që nxisin investimet për internet të shpejtë dhe internet ultra të shpejtë, duke u bazuar veçanërisht në zbatimin e besueshëm dhe të plotë të kuadrit rregullator të BE-së për komunikimet elektronike, zbatimin konsekuent të Programit Politik të Radiospektrit, masat e mjaftueshme për reduktimin e kostove dhe zbatimin e duhur të Udhëzimeve të Ndihmës Shtetërore për *broadband*.

Qeveria shqiptare me këtë rast paraqet Planin Kombëtar *Broadband* (PKB) për Shqipërinë, i cili përcakton vizionin politik dhe masat për zhvillimin e *broadband* në përshtatje me situatën dhe sfidat që përballet vendi, përfshirë sigurimin e shërbimeve *broadband* në zonat rurale. Përmes bashkëpunimit të sektorit publik dhe atij privat përfshirë industrinë, operatorët dhe ofruesit e shërbimeve, si edhe autoritetet e qeverisjes vendore (bashkitë, komunat), qeveria shqiptare synon të nxisë zhvillimin e *broadband* në Shqipëri dhe të ndërmarrë veprime konkrete për të përmirësuar disponueshmërinë, përballueshmërinë dhe aksesueshmërinë e shërbimeve të komunikimeve *broadband*.

Ky dokument analizon situatën aktuale institucionale, ligjore, teknike dhe rregullatore të Republikës së Shqipërisë dhe identifikon mundësitë për të përmirësuar aksesin e shërbimeve *broadband*, duke respektuar parimin e neutralitetit teknologjik dhe duke mos shkelur rregullat e konkurrencës. Ky plan merr parasysh kërkesën për aksesueshmëri të gjerë nga të gjitha grupet e popullsisë, sektori i biznesit dhe administrata publike, duke përfshirë promovimin e aksesit në shërbimet e shoqërisë së informacionit për zonat rurale dhe zonat e thella, në përputhje me politikat ekzistuese si Dokumenti i Politikës për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë 2010, Strategjia Ndërsektoriale e Shoqërisë së Informacionit, si dhe objektivat e parashtruar nga Komisioni i *Broadband* për Zhvillimin Digjital i krijuar nga ITU dhe UNESCO në maj të vitit 2010.

Ky plan përcakton qëllimet, objektivat dhe politikat që do të ndiqen për zhvillimin e *broadband* në Shqipëri. Ai, gjithashtu, thekson rëndësinë dhe rolet përkatëse të pjesëmarrjes së sektorit publik dhe privat dhe partneritetit midis tyre, si në aspektin e përcaktimit të qëllimeve, projekteve dhe çështjeve thelbësore, ashtu edhe në krijimin e një shumëllojshmërie modelesh financiare.

1. Analizë e situatës aktuale

1.1 Informacion i përgjithshëm rreth vendit

Republika e Shqipërisë ndodhet në rajonin e Europës Juglindore, në perëndim të gadishullit Ballkanik, përgjatë deteve Adriatik dhe Jon. Shqipëria është pozicionuar midis koordinatave gjeografike: 39^{o}38’ (Konispol) dhe 42^{o}30’ (Vermosh) në veri-jug, 19^{o}16’ (Ishulli i Sazanit) dhe 21^{o}40’ (fshati Vernik, Korçë) në perëndim-lindje. Territori i Shqipërisë ka një sipërfaqe prej 28748 km^{2} dhe ka një popullsi prej 2 821 977 banorësh (sipas censusit në tetor, 2011).

Shqipëria ka pasur rritje ekonomike dhe ka gëzuar një qëndrueshmëri makroekonomike. Reformat makroekonomike në Shqipëri kanë kontribuar në rritjen ekonomike, uljen e varfërisë dhe inflacion të zbutur.



Figura 1. GDP në Shqipëri[1]

Sipas të dhënave të publikuara nga Banka e Shqipërisë, rritja ekonomike e nëntëmujorit të parë të vitit 2011, ishte rreth nivelit 2.7%[2] ndërsa inflacioni mesatar i vitit 2011 shënoi vlerën 3.5%, me gjithë luhatjet gjatë vitit, të shkaktuara më së shumti nga goditje të ekonomisë së huaj.

Popullsia që jeton në zonën urbane e ka tejkaluar numrin e popullsisë që jeton në zonën rurale. Popullsia banuese në zonën urbane është 53,5% dhe 46,5% e popullsisë jeton në zonën rurale. Mosha mesatare e popullsisë banuese është rritur nga 30,6 vjeç në vitin 2001 në 35,3 vjeç në vitin 2011[3].

Shqipëria është e ndarë në 12 qarqe, 36 rrethe dhe 374 bashki/komuna. 72 bashki kanë statusin e qytetit. Gjithsej janë 2980 fshatra. Çdo rreth ka këshillin e tij, i cili është i përbërë nga një numër bashkish. Komunat dhe bashkitë janë njësi bazë të qeverisjes vendore dhe përbëjnë nivelin e parë të qeverisjes.

Sektori privat kontribuon 80% në GDP dhe rreth 82% në punësim. Duke njohur rëndësinë e investimeve private, qeveria shqiptare ka ndërmarrë një reformë gjithëpërfshirëse rregullatore për të krijuar një ambient të përshtatshëm biznesi dhe investimesh, veçanërisht duke ulur pengesat administrative, si dhe kostot për të ngritur një biznes. Kështu, procedurat e regjistrimit dhe e licencimit të biznesit janë lehtësuar me ngritjen e Qendrës Kombëtare të Licencimit, e cila ka zgjeruar rrjetin e shërbimeve të saj edhe në qytetet jashtë Tiranës. Në mars 2011 u bë operacional sistemi i nënshkrimit elektronik (*e-signature*), i cili pranon aplikimet *online* për regjistrim dhe në qershor 2011 u bë operacionale Agjencia e Zhvillimit të Investimeve Shqiptare, e cila shërben si një qendër e vetme (*one stop shop*) për investitorët e huaj. U amendua ligji për investimet e huaja direkte për të garantuar mbrojtje të veçantë për investitorët e huaj në rastin e mosmarrëveshjeve të pronësisë së tokës, sipas disa kushteve të caktuara.

Sistemi financiar në Shqipëri mbizotërohet nga sektori bankar, i cili është përgjegjës për 95% të aseteve (aktiveve) totale të sistemit.

Komunikimet elektronike përbëjnë një sektor shumë të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare. Ky sektor ka gjeneruar të ardhura mjaft domethënëse në Shqipëri. Për sa u takon, të ardhurave totale të sipërmarrësve në tregun e komunikimeve elektronike për vitin 2011, ato kanë qenë 51 922 milionë lekë, të cilat përbëjnë një reduktim prej rreth 9% në krahasim me vitin 2010 kur të ardhurat e tyre ishin 57 087 milionë lekë. Ky reduktim i të ardhurave është në tendencë të kundërt me volumin e shërbimeve të cilat janë rritur ndjeshëm gjatë vitit 2011 (internet dhe telefoni celulare). Reduktimi i të

[1] Burimi: INSTAT: http://www.instat.gov.al/.
[2] Burimi: Banka e Shqipërisë: http://bankofalbania.al.
[3] Burimi: Cencus-AL 2011.

ardhurave të sektorit rezulton të jetë kryesisht si pasojë e reduktimit të të ardhurave të operatorëve celularë gjatë vitit 2011.



Figura 2. Të ardhurat e operatorëve[4]

Qeveria vazhdon të promovojë futjen në përdorim të TIK-ut në sektorë të ndryshëm. Kështu, gjatë viteve 2010 dhe 2011, shpenzimet e buxhetit në arsim, ku një vend të veçantë i është dhënë përdorimit të TIK-ut, u vlerësuan, të jenë ndërmjet 3.4 dhe 3.8% të GDP-së. TIK iu shtua kurrikulës për 17 qendra arsimore profesionale dhe shkolla trajnimi. Shpenzimet publike në kërkim e zhvillim llogariten të jenë 0.05% e GDP-së së buxhetit të vitit 2011. Progres, gjithashtu, u arrit edhe nga Shërbimet Kombëtare të Punësimit duke përmirësuar sistemin e informacionit për vendet e lira të punës.

Ambicia afatmesme ekonomike e Shqipërisë, sikurse është shprehur në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013, Politikën për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë dhe përmes marrëveshjes dhe marrëdhënieve politike me Bashkimin Europian, është që të arrihet integrimi në tregun e Bashkimit Europian.

Kjo nënkupton adoptimin e *acquis communautaire*, si dhe një konvergjencë të nivelit ekonomik të Shqipërisë në mesataren e BE-së nëpërmjet disponueshmërisë së infrastrukturës së nevojshme (përfshirë TIK), shërbimeve dhe programeve që synojnë krijimin e mjedisit të nevojshëm fiskal dhe tregtar, për të promovuar investimet e huaja, për të rritur produktivitetin dhe për të rritur tregtinë, si dhe për të krijuar kushtet për disponueshmërinë në të ardhmen të financimeve të BE-së.

1.2 Kuadri ligjor dhe rregullator për Komunikimet Elektronike.

Shqipëria implementoi kuadrin e ri ligjor të Bashkimit Europian në fushën e komunikimeve elektronike në vitin 2008, me miratimin e ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" (paketën e direktivave të BE-së të vitit 2002). Ky ligj vendosi kalimin në regjimin e autorizimit të përgjithshëm për të gjitha rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.

Me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012, janë miratuar ndryshime në këtë ligj me qëllim përafrimin e plotë të tij me *acquis communaitaire* më të fundit (direktivën 2009/136/EC dhe direktivën 2009/140/EC, të cilat amenduan direktivat e vitit 2002).

Një sërë ligjesh të tjera të rëndësishme për zhvillimin e Shoqërisë së Informacionit, janë miratuar nga viti 2008:

- Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale: ligji nr. 9887, datë 10.3.2008.
- Ligji për nënshkrimin elektronik: ligji nr. 9880, datë 25.2.2008.
- Legjislacioni për krimin kibernetik: miratuar në 2008.
- Ligji për tregtinë elektronike: ligji nr. 10 128, datë 11.5.2009.
- Ligji për dokumentin elektronik: ligji nr. 10 278 datë 29.4.2010.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ka marrë disa vendime për të nxitur konkurrencën dhe reduktuar çmimet në tregun e komunikimeve elektronike, ndër të cilat:

- Rregullorja për analizën e tregut e miratuar më 17 korrik 2009 nga AKEP-i, përcakton tregjet

[4] Burimi: AKEP.

përkatëse që i nënshtrohen rregullimit. Lista përbëhet nga 16 tregje sipas rekomandimit të BE-së të vitit 2003 (të gjitha tregjet me përjashtim për shërbimet radiotelevizive dhe *roaming* ndërkombëtar);

- Rregullimi i tarifës në mënyrë të përshkallëzuar për terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare në tregun me shumicë, bazuar në modelin e BU-LRAIC;
- Rregullimi i tarifës në mënyrë të përshkallëzuar për terminimin e mesazheve SMS në rrjetet celulare në tregun me shumicë, bazuar në modelin BU-LRAIC;
- Analizën e tregjeve me pakicë dhe me shumicë të linjave me qira;
- Masa rregullatore për implementimin e portabilitetit të numrave celularë;
- Rregullim për hapjen e qarkut lokal të operatorit *incumbent* për akses të plotë dhe akses të përbashkët.

Rregullimin e tregut për operatorët OFNT, në veçanti për tregun me shumicë të aksesit në infrastrukturën e rrjeteve fizike (përfshirë aksesin e ndarë të pjesshëm ose të plotë) nga vendndodhje fikse dhe tregun me shumicë të aksesit *broadband,* duke vendosur detyrimet për transparencën, mosdiskriminimin (publikimin e ofertës referencë RUO).

Detyrime të tjera janë vendosur nga AKEP në tregun me pakicë për minimumin e linjave me qira (i cili përfshin lloje të specifikuara të linjave me qira deri në 2Mb/sek), tregun me shumicë të segmenteve terminuese të linjave me qira dhe tregun me shumicë të linjave kryesore (*trunk*) të linjave me qira.

Gjithashtu, ka pasur progres në përcaktimin e disa masave për të mbrojtur konkurrencën siç është implementimi i portabilitetit të numrit celular, vendime për ofertën e referencës për interkoneksionin, si dhe kontrollin e tarifave dhe orientimin e tyre në kosto (sipas BULRAIC). Implementimi i zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit u vendosën si detyrim për thirrjet ndërkombëtare dhe për thirrjet kombëtare.

Duke njohur nevojën e marrjes së masave për të nxitur investimet private në infrastrukturë (përfshirë *broadband*), në mënyrë të ngjashme me praktikat e autoriteteve rregullatore në Francë dhe Portugali, AKEP-i ka përgatitur hartën e infrastrukturës ekzistuese në formën e një atlasi elektronik të infrastrukturës, duke përfshirë rrjetet ekzistuese dhe elemente të tjera pasive, duke orientuar në masat e nevojshme për lehtësimin e përdorimit të tyre për shtrirjen e rrjetit NGA (Next Generation Access).

Qeveria dhe rregullatori janë duke analizuar alternativat për një shpërndarje dhe administrim më eficent të spektrit të frekuencave. Amendimet e ligjit 9918/2008 parashikojnë dhënien në përdorim të frekuencave mbi bazën e parimit teknologji-neutral, si dhe heqjen e kufizimeve teknologjike në përdorimin e frekuencave të dhëna.

Qeveria, gjithashtu, ka analizuar brezin e digjital dividendit dhe kërkon të promovojë një përdorim eficent të tij. Aktualisht frekuencat e digjital dividentit (790-862 Mhz) janë në përdorim për transmetime radiotelevizive, por bazuar në strategjinë për kalimet nga transmetimet analoge në ato numerike miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 292 datë 2.5.2012, ky brez do të kalojë për shërbime të tjera të komunikimeve elektronike, në veçanti për *broadband*. Nga rregullatorët do të kryhen studime për sigurimin e një përdorimi efektiv të spektrit të frekuencave.

Qëllimi i këtyre studimeve është rritja e efektivitetit të përdorimit të spektrit të frekuencave; ofrimi i një pamje të qartë të aspektit rregullator në lidhje me kushtet teknike që duhet të përmbushen në çdo përdorim të brezave të ndryshëm (nivelin e interferencës së lejueshme, fuqinë, shpërndarjen etj.) dhe për të inkurajuar përdorimin e teknologjisë digjitale në brezat e përcaktuar.

1.3 Strategjitë e politikat për zhvillimin e TIK

Shqipëria ka miratuar një sërë dokumentesh politike, të cilat njohin rolin e rëndësishëm të TIK-ut në zhvillimin kombëtar dhe kanë për qëllim të promovojnë zhvillimin e sektorit.

1.3.1 Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin 2007-2013

Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin (SKZHI) 2007-2013 përfaqëson dokumentin strategjik themelor të vendit që harmonizon për herë të parë në një dokument të vetëm strategjik, perspektivën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social, integrimin në Bashkimin Europian dhe strukturat e NATO-s, si dhe arritjen e objektivave të zhvillimit të mijëvjeçarit. SKZHI u finalizua në dhjetor të vitit 2007 dhe u miratua nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 342, datë 12.3.2008. Aktualisht është në përfundim strategjia e re 2013-2020, e cila e vendos TIK-un dhe programin digjital si një nga prioritetet madhore të zhvillimit.

Objektivi kryesor i SKZHI-së në lidhje me TIK-un ishte përgatitja e një politike, strategjie dhe planzbatimi në mënyrë që të shfrytëzohen dhe zhvillohen më tej potencialet e TIK-ut, me qëllim

shtimin e njohurive, rritjen e efektivitetit dhe transparencës në administratën publike.

1.3.2 Strategjia Ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit 2008-2013

Strategjia për Shoqërinë e Informacionit u miratua nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 59, datë 21.1.2009. Vizioni i saj është që të arrihet:

"Progresi i Shqipërisë drejt një ekonomie të bazuar në njohuritë, përmes një zhvillimi të qëndrueshëm të shoqërisë së informacionit që do të çojë në një shoqëri ku të gjithë qytetarët përfitojnë nga teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit me qëllim shtimin e njohurive, rritjen e efektshmërisë dhe të transparencës në administratën publike."

Objektivat kryesorë të Strategjisë janë:

- Zhvillimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së shoqërisë së informacionit;
- Plotësimi dhe përmirësimi i legjislacionit përkatës për shoqërinë e informacionit;
- Nxitja dhe mbështetja për zhvillimin e shoqërisë së informacionit;
- Nxitja dhe mbështetja për zhvillimin e sektorit privat të TIK-ut;
- Rritja e nivelit të njohurive dhe të informacionit në lidhje me Shoqërinë e Informacionit dhe koordinimi i veprimeve të përbashkëta ndërmjet shtetit dhe qytetarëve.

1.3.3 Dokumenti i politikave për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë (2010)

Dokumenti i politikave të komunikimeve elektronike u miratua nga Këshilli i Ministrave në maj 2010. Ky dokument politikash përcakton strategjinë afatmesme të qeverisë për zhvillimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë.

Vizioni i kësaj politike është që brenda shtatë viteve, komunikimet elektronike të ofrohen nga një mori operatorësh në një mjedis me konkurrencë efektive, duke përdorur një gamë të gjerë teknologjish, të cilat janë të lira të bartin të gjitha llojet e përmbajtjeve. Kjo politikë, gjithashtu, ka objektiv që aksesi në *broadband*, me shpejtësi të lartë, të jetë i disponueshëm për një pjesë të madhe të familjeve që dëshirojnë ta kenë atë.

1.3.4 Strategjia e kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike

Strategjia e Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetime Numerike (transmetime radiotelevizive) u miratua nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 292, datë 2.5.2012. Strategjia përcakton si afat të përfundimit të *sëitchover*-it, datën 17 qershor 2015, që është dhe afati i fundit i vendosur në marrëveshjen GE-06. Kjo strategji është me rëndësi të veçantë pasi mbyllja e transmetimeve analoge do të çojë në lirimin e spektrit të digjital dividentit, i cili do të mund të përdoret për zhvillimin e shërbimeve të tjera të komunikimeve elektronike përfshirë shërbimet me brez të gjerë.

(Ndryshuar me VKM nr.300, datë 8.04.2015)

1.3.5 "Strategjia Axhenda Dixhitale 2014-2020"

Strategjia Axhenda Dixhitale 2014-2020", e hartuar gjatë vitit 2014, do të zëvendësojë Strategjinë Ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit, të miratuar në vitin 2009. Vizioni i kësaj strategjie është:

Një shoqëri e bazuar në dije dhe informacion për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social, konsolidim të infrastrukturës dixhitale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke respektuar me rigorozitet parimet evropiane të konkurrencës së lirë e të ndershme, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve publike dhe duke rritur transparencën e qeverisjes.

Zhvillimi i infrastrukturës së përparuar të komunikimeve elektronike përcaktohet si një nga drejtimet kryesore të kësaj strategjie, duke e parë atë të lidhur me hapat për sigurimin e spektrit të mjaftueshëm për zhvillimet në perspektivën e infrastrukturës Broadband (NGN/LTE/5G etj), si dhe me krijimin e kuadrit ligjor e rregullator për të drejtën e kalimit.

(Zevendësuar teksti 1.4 me VKM nr.300, datë 8.04.2015)

1.4 Kuadri institucional

Ministri përgjegjës për komunikimet elektronike i propozon Këshillit të Ministrave strategjitë e zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike, aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për përmbushjen e objektivave të përcaktuar në dokumentin e politikave të komunikimeve elektronike. Detyrat e ministrit përgjegjës për komunikimet elektronike përcaktohen në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 97/2013, për median audiovizive.

Organet rregullatore, AKEP dhe AMA, janë dy institucione të rëndësishme në aspektin e

rregullimit të komunikimeve elektronike dhe median elektronike. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është organi rregullator i pavarur në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimin postar (http://ëëë.akep.al), i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ligji për komunikimet elektronike, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Kompetencat dhe detyrat e AKEP-it për komunikimet elektronike janë përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA) është autoritet rregullator i pavarur i cili rregullon dhe mbikëqyr veprimtarinë radiotelevizive në Republikën e Shqipërisë. AMA ushtron veprimtarinë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 97/2013, "Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë". AMA gjithashtu administron dhe menaxhon spektrin e radiofrekuencave të caktuara për transmetime radioje dhe ato televizive, në përputhje me përcaktimet për shërbimet radiotelevizive në Planin Kombëtar të Radiofrekuencave, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Në fushën e implementimit dhe për rritjen e kërkesës për shërbime *broadband* luajnë rol të rëndësishëm dhe një numër institucionesh të tjera, si AKSHI, ASIG, ALCIRT, AKCE etj.

1.4.1 Roli i Ministrit

Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit (http://ëëë.mitik.gov.al) është Ministri përgjegjës për komunikimet elektronike, i cili i propozon Këshillit të Ministrave strategjitë e zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike, aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për përmbushjen e objektivave të përcaktuar në dokumentin e politikave të komunikimeve elektronike.

Në lidhje me fushën e shoqërisë së informacionit *Ministri përgjegjës për komunikimet elektronike* dhe Komunikimit ka këto detyra kryesore:

- Të zhvillojë dhe të implementojë një strategji të integruar për të mundësuar përdorimin masiv të teknologjive të informacionit dhe komunikimit, drejt krijimit të një shoqërie të mbështetur në dije.
- Të mundësojë zhvillimin e shërbimeve të reja elektronike për biznesin dhe qytetarët dhe të shtyjë përpara harmonizimin e kuadrit ligjor të fushës me atë të BE-së.
- Të zhvillojë një kuadër ligjor të plotë për TIK-un dhe shërbimet postare dhe të sigurojë zbatimin efektiv të tij.
- Të angazhohet në projektet e qeverisjes elektronike dhe të promovojë integrimin e TIK-ut në të gjitha fushat e zhvillimit ekonomik.

Në mbështetje të programit të qeverisë, Shqipëria digjitale, në fund të vitit 2009, u krijua Departamenti i Shqipërisë Digjitale. Departamenti është në vartësi direkte të Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimeve.

1.4.2 Organet rregullatore

1.4.2.1 Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është organi rregullator i pavarur në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimin postar (http://ëëë.akep.al), i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ligji për komunikimet elektronike, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

AKEP-i është një person juridik, publik, jobuxhetor, i pavarur, drejtuar nga Këshilli Drejtues, i cili është i pavarur në marrjen e vendimeve të tij dhe funksionon në bazë të rregullores së brendshme, të miratuar nga ai vetë. Kryetari i Këshillit Drejtues është, gjithashtu, drejtuesi ekzekutiv i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Kompetencat dhe detyrat e AKEP-it për komunikimet elektronike janë përcaktuar në ligjin nr. 9918/2008 për Komunikimet Elektronike, të ndryshuar.

1.4.2.2 Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT)

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit është autoritet rregullator i pavarur i cili rregullon dhe mbikëqyr veprimtarinë radiotelevizive në Republikën e Shqipërisë (http://ëëë.kkrt.gov.al).

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, gjithashtu, administron dhe menaxhon spektrin e radiofrekuencave të caktuara për transmetime radio dhe televizive, në përputhje me përcaktimet për shërbimet radiotelevizive në "Planin kombëtar të radiofrekuencave" të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

1.4.3 Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)

AKSHI (http://ëëë.akshi.gov.al) është agjenci në varësi të Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit. Roli dhe funksionimi i AKSHI-it përcaktohen në vendimin e Këshilli të Ministrave nr. 248, datë 27.4.2007 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit" të ndryshuar. AKSHI ka objekt të veprimtarisë:

- Zbatimin e politikave e të strategjive, për zhvillimin e sektorit të Shoqërisë së Informacionit (SHI) dhe në veçanti të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK).
- Bashkërendimin e programeve në fushën e SHI-së dhe në veçanti të TIK-ut;
- Nxitjen e investimeve në fushën e SHI-së.
- Hartimin e praktikave për ushtrimin e kompetencave që i jepen ministrit nga legjislacioni në fushën e komunikimeve elektronike.
- Promovimin e teknologjive të reja në fushën e SHI-së.
- Dhënien e kontributit në edukimin dhe nxitjen e përdorimit të TIK-ut nga publiku.

AKSHI zhvillon rrjetin e brendshëm të TIK për administratën publike, duke përfshirë rrjetin qeveritar, portalin qeveritar etj. AKSHI, gjithashtu, është autoriteti rregullator dhe koordinues i bazës së të dhënave shtetërore.

1.5 Situata aktuale në tregun e komunikimeve elektronike

Tregu i komunikimeve elektronike në Shqipëri ka njohur një zhvillim të shpejtë me liberalizimin e plotë të tij, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".

Aktualisht, Shqipëria ka një nga nivelet më të larta të përdorimit të telefonit celular në Europë. Penetrimi i telefonisë celulare në fund të vitit 2012 ka arritur nivelin afër 190%.

Sipas të dhënave të ofruesve të shërbimit internet (ISP) për vitin 2010, numri i pikave Ëi-Fi Hot Spots vlerësohet të ishte rreth 1400, ndërsa numri i internet kafeve rreth 1000. Pika të tilla aksesi janë të rëndësishme në mënyrë që të gjitha nivelet e popullsisë të mund të kenë akses në TIK. Gjatë vitit 2010 Posta Shqiptare ngriti në 550 zyrat postare në të gjithë vendin pikat e aksesit publik. Gjatë vitit 2012 pikat e aksesit publik në të gjithë vendin janë shtuar në 1800.

Zhvillimi i mëtejshëm i rrjeteve të komunikimeve elektronike (fiks dhe celular) në një farë mënyre ka qenë i kufizuar nga një sërë faktorësh. Ndër këta faktorë janë karakteristikat gjeografike të vendit tonë, si terreni malor në pjesën më të madhe të vendit, popullsia jo e dendur dhe niveli i ulët i të ardhurave në pjesën më të madhe të popullsisë, veçanërisht në zonat rurale. Këta faktorë kanë ndikuar në koston dhe rrezikun financiar për zhvillimin e rrjeteve dhe shërbimeve, përfshirë shërbimet *broadband* dhe veçanërisht zgjidhjet teknike me fibër optike, në të gjithë Shqipërinë. Qeveria është e vetëdijshme për kufizime të tilla dhe është duke punuar në mënyrë aktive për të krijuar kuadrin e nevojshëm ligjor dhe rregullator për të inkurajuar investimet.

Në vendin tonë janë shtruar kabllo të fibrës optike nga "Albtelecom" dhe operatorë të tjerë alternativë, edhe pse zgjerimi i rrjeteve private me fibër optike ka hasur vështirësi për shkak të shpenzimeve të larta dhe problemeve lidhur me të drejtën e kalimit në pronë të shtetit dhe pronë private. Është përgatitur drafti i ligjit lidhur me të drejtën e kalimit në pronën e shtetit dhe private që pritet të miratohet nga Kuvendi Shqiptar.

Operatorët alternativë kanë zgjeruar zonat e tyre të ofrimit të shërbimit, edhe pse ato janë kryesisht të përqendruar në zonat urbane dhe zonat rurale pranë qyteteve. Disa nga këta operatorë ofrojnë paketat *triple-play* (internet, telefoni dhe TV) nëpërmjet aksesit të internetit *broadband*.

Në vitin 2011, qeveria hapi tenderin për ndërtimin dhe operimin e kurrizores kombëtare me brez të gjerë të fibrës optike. Fatkeqësisht ky proces u anulua, por duke pasur parasysh rëndësinë e *broadband*, qeveria është duke rivlerësuar situatën dhe pritet që të ndërmerren masa të rëndësishme për zhvillimin e *broadband*.

Aktualisht janë 4 operatorë celularë në Shqipëri, tre prej tyre janë të licencuar/autorizuar dhe ofrojnë shërbimin mobile *broadband* në UMTS/3G.

Në fund të vitit 2011, numri i pajtimtarëve të telefonisë së lëvizshme u rrit me 15% krahasuar me vitin 2010 dhe arriti përafërsisht 5.2 milionë, i cili përbën një normë penetrimi (numri i përdoruesve për 100 banorë) prej 185%, që është shumë më e lartë se niveli prej 140% në vitin 2010 apo niveli mesatar në vendet e BE-së prej 124% në 2010.

Operatorët e telefonisë së lëvizshme kanë qenë shumë aktivë në ofrimin e shërbimeve të internetit nëpërmjet pajisjeve celulare dhe kartave modem për PC, duke ofruar reduktime të ndjeshme

të tarifave të këtij shërbimi për përdoruesit me kontratë dhe me parapagim. Në fund të vitit 2011, numri i pajtimtarëve celularë (me kontratë dhe me parapagim) që kanë akses në internet nëpërmjet aparatit celular me GPRS/EDGE është vlerësuar të jetë më shumë se 1.2 milionë përdorues.

Në fund të vitit 2011, numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse u rrit në 339 000, duke sjellë një shkallë penetrimi të telefonisë fikse në Shqipëri në 12% krahasuar me 10% që ka qenë në vitin 2010.



Figura 3. Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse dhe celulare në 2000-2011[5]

Qeveria është e ndërgjegjshme që ky nivel është shumë i ulët krahasuar me vendet e BE-së dhe vendet e rajonit dhe prandaj është duke bërë përpjekje konkrete për të rritur prezencën e infrastrukturës së TIK-ut, përfshirë edhe infrastrukturën *broadband*.



	Fixed Broadband	Mobile Broadband	Fixed Telephony	Mobile Telephony	Broadband per household
Albania 2011	4.93%	1.22%	11.97%	184.92%	19.05%
EU 27 2010/2011	27.20%	7.50%	45.00%	124.20%	60.80%

Figura 4. Krahasimi i niveleve të penetrimit (popullsia): Shqipëria ndaj mesatares së BE27 [6]

Numri i përdoruesve të shërbimeve *broadband* është rritur me përdorimin e teknologjisë ADSL dhe teknologjisë 3G. Operatorët kanë filluar të investojnë në shtrimin e fibrës optike, përfshirë edhe operatorët alternativë. Sipas të dhënave të korrikut 2012, gjatësia e fibrës optike të instaluar nga operatorët është afërsisht 5700 km nga rreth 4600 që ishte në fund të vitit 2011. "Albtelecom" ka kryer investime të konsiderueshme në NGA duke instaluar një numër të konsiderueshëm MSAN për lidhjen e të gjithë abonentëve në rrjetin NGA/NGN. Kompanitë ofrojnë shërbime në të gjitha zonat urbane dhe pjesën më të madhe të zonave rurale nëpërmjet interkoneksionit me operatorët e tjerë alternativë. Në vitin 2011, "Albtelecom" nisi të ofrojë paketën e parë dyfishe e cila përfshin ofrimin e *broadband*

[5] Burimi: AKEP.
[6] Burimi: AKEP.

me shpejtësi 2Mbps dhe 1500 minuta bisedë në Shqipëri dhe jashtë saj. "Albtelecom", gjithashtu, ofron lidhjen e internetit nëpër shkolla në të gjithë vendin sipas kontratës së tij me Ministrinë e Arsimit.

Një numër i konsiderueshëm i lidhjeve *broadband* nga operatorët alternativë kryhet me kombinim fibër optike, kabllo koaksial apo linjë bakri. Sipas të dhënave ABCom, ASC, Nisatel, Primo dhe AMC fiks (që ka filluar në dhjetor 2011 ofrimin e shërbimit të telefonisë fikse me numra fiks, duke përdorur rrjetin GSM) janë pesë operatorët alternativë më të mëdhenj që zotërojnë rreth 67% të numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse të operatorëve alternativë. ABCom dhe ASC kanë rritjen më të madhe vjetore me 36% dhe 37% respektivisht, si edhe AMC që për vetëm 1 muaj aktivitet në ofrimin e shërbimit të telefonisë fikse me numra fiks, duke përdorur rrjetin GSM ka arritur të kapë 2% pjesë tregu. ABCom vazhdon të jetë operatori më i madh alternativ fiks me rreth 27 mijë pajtimtarë. Vlen të theksohet se ABCom dhe ASC si dy operatorët alternativë më të mëdhenj janë prezent në treg me oferta "triple-play", duke ofruar internet *broadband*, telefoni dhe TV.

Sipas të dhënave të vitit 2011, nga Albtelecom, operatorët alternativë, Vodafone dhe AMC për numrin e pajtimtarëve me akses në *broadband* 3G (me karta USB/modem), si dhe vlerësimeve të AKEP, rezulton se numri i familjeve që kanë akses në internet me bandë të gjerë (broadband) është rreth 161 mijë apo afërsisht 22% e familjeve, ndërsa vlerësohen të jenë mbi 13.000 pajtimtarë biznesi. Bazuar në këto të dhëna, numri i lidhjeve me akses *broadband* (fiks dhe 3G-USB/modem) për 100 banorë është rreth 6.2% krahasuar me 3.7% në fund të vitit 2010.



Figura 5. Infrastruktura e rrjeteve kabllore në Shqipëri[7]

Mungesa e lidhjeve me kapacitet të lartë me fibër optike me vendet fqinje ka qenë një problem, për këtë arsye operatorët alternativë ishin fokusuar në përdorimin e lidhjeve mikrovalore në vend të fibrës optike për të realizuar lidhjet e tyre. Situata e lidhjeve ndërkombëtare me fibër optike është përmirësuar dukshëm në dy-tri vitet e fundit.

Tabela 1. Performanca e konektivitetit me internetin global - lidhje ndërkombëtare

Kapaciteti total i lidhjeve ndërkombëtare të internetit			
2009	**2010**	**2011**	**Rritja 2009-2011**
6 Gbps	14Gbps	30Gbps	**5 herë**

Burimi: Raportet vjetore të AKEP-it

[7] Burimi: AKEP.

Gjatë viteve 2010-2012 u zhvilluan disa ndryshime të rëndësishme për sigurimin e aksesit të internetit me brez të gjerë:

- Rritja e shpejtësisë së aksesit të *broadband* ADSL nga 256 Kbps- 2 Mbps në 2 Mbps-12 Mbps, ku shpejtësia minimale dhe më e përdorur është 2 Mbps krahasuar me 256 Kbps që ka qenë në vitin 2009.
- Konektiviteti me internetin global (lidhjet direkte ndërkombëtare) është rritur nga 6 Gbps në fund të vitit 2009 në 14 Gbps në fund të vitit 2010 dhe rreth 30 Gbps në fund të vitit 2011.
- Sigurimi i paketës së ofrimit të 3 shërbimeve: internet, TV dhe telefoni.
- Reduktim i ndjeshëm i tarifës së aksesit të *broadband*.
- U realizua konektiviteti me fibër optike me kapacitet të lartë me Kosovën.

Tabela 1. Penetrimi i *broadband* në vitet 2007-2011

Penetrimi i *broadband* 2007-2011, numri i lidhjeve për 100 banorë				
2007	**2009**	**2010**	**2011**	**Rritje 2007-2011**
0.33%	2.5%	3.7%	6.2%	**> 18 herë**

Burimi. Raportet vjetore të AKEP

Gjatë vitit 2011, rritje të ndjeshme në lidhjet *broadband* kanë pasur operatorët alternativë dhe dy operatorët celularë Vodafone dhe AMC, ndërsa "Albtelecom" ka pësuar rënie të numrit të lidhjeve *broadband*. Ndër operatorët alternativë fiks, ABCom vazhdon të jetë operatori me numrin më të madh të lidhjeve *broadband* me rreth 30 mijë në fund të vitit 2011, që përbën një rritje prej 116% nga viti 2010.

1.6 Kërkesat aktuale për TIK-un

Një element thelbësor për të inkurajuar operatorët që të investojnë për zhvillimin e rrjeteve/shërbimeve *broadband* dhe për të zvogëluar hendekun midis operatorëve që planifikojnë të investojnë në infrastrukturën e rrjetit dhe investimeve që nevojiten për të realizuar objektivat për zhvillimin e *broadband* është "nxitja e kërkesës". Operatorët hezitojnë në ndërtimin e rrjeteve me brez të gjerë dhe shpejtësi të lartë nëse kërkesa e konsumatorit do të jetë e ulët, dhe kjo kërkesë është e ulët për sa kohë ka pak aplikacione dhe shërbime që kanë nevojë për brez të gjerë.

Qeveria shqiptare është e vetëdijshme për nevojën e TIK-ut, për një zhvillim më të madh ekonomik dhe shoqëror dhe ka bërë një përpjekje të bashkërenduar në dekadën e fundit për të stimuluar kërkesën për shërbime të TIK-ut, përmes qeverisë dhe përmes zhvillimit të aksesit të shërbimeve të TIK-ut, si ofrimit të internetit falas në zyrat postare ose promovimit të internetit nëpër shkolla.

1.6.1 Kërkesa nga qeveria (iniciativat e qeverisjes elektronike, *e-government*)

Zhvillimi i shoqërisë së informacionit dhe i TIK-ut ka qenë një ndër prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare, duke promovuar TIK në të gjitha sferat e jetës.

Qeveria përcakton mënyrat që duhen ndjekur, ofron kuadrin e duhur ligjor dhe rregullator dhe stimulon investimet për zhvillimin e TIK-ut në gjithë vendin. Nëpërmjet aplikacioneve të qeverisjes elektronike (*e-government*), qeveria mund të ndryshojë veprimtarinë e saj dhe mënyrën e ndërveprimit me qytetarët dhe bizneset.

Në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit, në administratën publike janë në proces e sipër rreth 125 projekte të TIK-ut. Shumë shërbime publike që kanë të bëjnë me bizneset dhe individët janë tashmë *online*. Sistemi i kabinetit elektronik (*e-Cabinet*), i implementuar në vitin 2009, platforma e re e akteve elektronike (*e-Akte*) u implementua në vitin 2012 që inkorporon në sistem më shumë se 1500 përdorues nga të gjitha ministritë. Në vijim, rrjeti qeveritar GovNET është duke u zgjeruar edhe për institucionet e qeverisjes lokale, si dhe shumë shërbime të rëndësishme publike si regjistrimi i pronës private, sistemi i çështjeve gjyqësore dhe shërbime të tjera mundësohen elektronikisht.

Është duke u përgatitur kuadri ligjor për Interoperabilitetin e qeverisjes elektronike (e-GIF), i cili do të bëjë të mundur shkëmbimin e informacionit midis institucioneve të administratës publike.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka ndërtuar një sistem Qendër të Dhënash me kapacitet të lartë (*Datacenter*), e cila do të bëjë të mundur që të gjitha shërbimet publike *online* të jenë të centralizuar dhe të integruar. AKSHI ka implementuar sistemin e Interoperabilitetit të qeverisjes elektronike (e-GIF) ku do fillojnë të lidhen të gjitha sistemet që operojnë me databaza shtetërore.

Portali i unifikuar i shërbimeve publike u lancua nga AKSHI më 28 nëntor 2012. Portali jep informacion në format të standardizuar për 400 shërbime publike në nivel qendror. Portali është ndërtuar me mundësinë e integrimit të të gjitha shërbimeve që do të ofrohen *online* me anë të interoperabilitetit.

Sistemi i prokurimit elektronik u implementua në fund të vitit 2007 dhe, që nga viti 2009 Shqipëria ka arritur ofrimin e shërbimeve të prokurimit publik elektronik në nivelin 100%.

Në fushën e doganave është zhvilluar më tej sistemi i e-doganave ku është vënë në funksionim sistemi i ri i akcizës, i cili ofron akses dhe shërbime *online* për operatorët ekonomikë; sistemi u bën të mundur operatorëve që të kontrollojnë *online* statusin e deklaratave/formularëve të tyre, transitin dhe gjendjen e llogarisë dhe ky sistem do të fillojë të përgatisë përpunimin e pagesave *online*.

Shërbimet elektronike tatimore janë ofruar që nga viti 2008, dhe ndërkohë do të zhvillohet sistemi i deklarimit të të ardhurave personale (G2C). Aktualisht Administrata tatimore ka filluar implementimin e plotë të sistemit të taksës elektronike (e-Tax), i cili ka për qëllim integrimin e sistemit aktual të taksave dhe nënsistemit në një sistem të vetëm, duke pasur për qëllim rritjen e performancës së administratës tatimore.

Në sektorin e drejtësisë është realizuar digjitalizimi i procesit të transferimit të dosjeve brenda dhe midis niveleve të ndryshme të sistemit gjyqësor dhe të fillojë inspektimi *online* i gjykatave dhe i seancave gjyqësore në vend, i cili është një nga funksionet e reja që ofron Sistemi i Integruar i Informacionit për Menaxhimin e Rasteve/Çështjeve gjyqësore (Integrated Case Management Information System_ICMIS).

Është duke u punuar për zhvillimin e sistemit të punësimit elektronik (*e-Employment*), me qëllim digjitalizimin e informacionit në të gjitha zyrat e punësimit, konsolidimin e bazave të të dhënave për tregun e punës dhe krijimin e një regjistri të punëkërkuesve dhe punëdhënësve. Do të krijohet një faqe interneti për shërbimet sociale, së bashku me një hartë të të gjitha këtyre shërbimeve që ofrohen në Shqipëri.

Në fushën e arsimit, është vënë theksi mbi lidhjet internet në të gjitha shkollat e vendit, mbi masat që synojnë ngushtimin e hendekut digjital dhe masat që kanë për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për nevojën e TIK-ut në shkolla. Në vitin 2005 u miratua masterplani gjithëpërfshirës për shkollat (*e-schools*) dhe dy mijë shkollat publike tashmë janë pajisur me laboratorë kompjuterikë (27014 PC+Laptop) dhe janë të lidhura me internet. Që nga janari 2011 është raportuar që lidhjet internet në shkolla të jenë me shpejtësi shkarkimi prej 1 Mbps dhe shpejtësi upload 256 Kbps për çdo shkollë. Çdo shkollë shqiptare ka lidhje interneti, si dhe janë miratuar kurrikulat e TIK-ut.

Përveç kësaj, gjatë vitit 2012, u mundësua implementimi i procesit *online* për Maturën Shtetërore, i cili ndihmoi në aksesin më të madh të informacionit dhe shërbimeve për të gjithë. Agjencia Kombëtare e Provimit ka filluar provimet e profesioneve të rregulluara në mënyrë digjitale për vitin 2012, duke zhvilluar kështu një standard ndërkombëtar të testeve tërësisht digjitale. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) është duke përfunduar digjitalizimin e sistemit të saj të menaxhimit, si dhe modulin e parë të sistemit U-gov, një sistem në shërbim të universiteteve për menaxhimin e informacionit të brendshëm.

Ndër veprime të tjera që janë realizuar përmendim:

- 550 zyrat postare ofrojnë akses në internet (*broadband* internet) falas dhe planet janë për të zgjeruar mbulimin në të gjithë Shqipërinë.
- Regjistri Civil Kombëtar është digjitalizuar dhe dokumentet biometrike janë lëshuar që nga viti 2008. Lëshimi *online* i dokumenteve të regjistrit civil është i disponueshëm në 354 njësi regjistrimi të lidhura me një bazë të dhënash qendrore.
- Prokurimi publik është realizuar 100 % nëpërmjet mjeteve elektronike që nga viti 2009.
- Regjistrimi i biznesit është ofruar bazuar në parimin "*one stop shop*" që nga viti 2007.
- Qendra Kombëtare e Licencimit është duke ofruar shërbime bazuar në parimin "one stop

shop" që nga viti 2009.

- Shërbimet e qeverisjes elektronike (*e-government*) janë ofruar të paktën në nivelin e parë dhe të dytë.
- Krijimin e Qendrës së Inovacionit PROTIK.

Projektet kryesore të planifikuara për zhvillimin e TIK përfshijnë:

- Zhvillimin e "Cloud Computing" qeveritar.
- Zhvillimin e Sistemit të Informacionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të qeverisë.
- Zhvillimin e sistemit *Gateëay* qeveritare dhe shtresës së ndërveprimit për sistemet e informacionit shtetëror.
- Zgjerimin e sistemit *e-takse*.
- Zgjerimin e projektit PAP2 të Postës Shqiptare në 1800 pika të tjera aksesi publik për të ofruar internet te qytetarët.
- Zgjerimin e sistemit të thesarit.
- Zgjerimin e projektit *e-schools* me qëllim shtrirjen e internetit në çdo klasë.
- Krijimin e një parku të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit. Ndërtimi i rrjetit kombëtar me brez të gjerë.

1.6.2 Kërkesa nga biznesi

Nga studimet e INSTAT-it dhe rezultatet e anketës ASN për vitin 2011 vihet re se 23% e bizneseve kanë lidhje interneti. Ndërsa rezultatet e anketës ASN për vitin 2012, tregojnë se 31.7% e bizneseve përdorin internetin. Bazuar në të dhënat e AKEP-it numri i pajtimtarëve të biznesit për internet është rritur si më poshtë:

Tabela 3. Lidhje me internet

Numri i kontratave biznes për lidhjet në internet			
2009	**2010**	**2011**	**Rritja 2009-2011**
8000	10000	13000	1.6 herë

Burimi: Raportet vjetore të AKEP-it

1.6.3 Kërkesa nga qytetarët

Aksesi në *broadband* ose aksesi i internetit në shtëpi është mënyra më e përgjithshme për t'i lidhur njerëzit *online*. Në shtëpi, të gjithë banorët e shtëpisë mund të kenë akses në internet pavarësisht nëse ata janë në punë, shkojnë në shkollë, janë femra ose meshkuj, fëmijë, të rritur ose të moshuar:

Tabela 4: % e familjeve me lidhje Interneti

	% e familjeve me lidhje internet			
Viti	**2009**	**2010**	**2011**	**Rritja 2009-2011**
% penetrimit	10%	12%	22%	**2 herë**

Burimi: Raportet vjetore të AKEP-it

1.7 Financimi i TIK-ut

Shqipëria, ashtu si shumica e vendeve në Europë po përballet me sfida të mëdha për sa u takon investimeve në infrastrukturën e internetit me shpejtësi të lartë (*broadband*). Për të arritur mbulimin e gjithë vendit me rrjete dhe shërbime *broadband*, konkurruese e të avancuara nevojiten investime të mëdha.

Sipas kushteve të ndihmës për anëtarësimin në BE-së të vendit tonë, për qeverinë shqiptare janë të disponueshme mekanizma të caktuar financiarë. Kështu, është dhënë ndihma financiare e paraaderimit për Shqipërinë në kuadër të Instrumentit për Asistencën Paraanëtarësimit (IPA). Nëpërmjet programeve kombëtare IPA, BE-ja ka alokuar një shumë totale prej 83.2 milionë eurosh në vitin 2010 dhe 82 milionë euro për vitin 2011.

Viti 2010, gjithashtu, pati një progres në përgatitjen e dokumentit të planifikimit shumëvjeçar indikativ 2011-2013, i cili miratoi një program sektorial duke u përqendruar në çështjet e brendshme dhe të drejtësisë, reformën e administratës publike, transportin, mjedisin dhe ndryshimin e klimës, zhvillimin social, zhvillimin rural dhe bujqësor. MIPD 2011-2013 për Shqipërinë u miratua në korrik

2011.

Për financimin e zhvillimeve në *broadband* vendet e ndryshme të BE-së kanë ndjekur disa modele një përmbledhje e të cilave jepen në shtojcën 2 bashkëlidhur.

2. Vizioni politik dhe objektivat që synohen të arrihen

Zhvillimi i sektorit të komunikimeve elektronike ka qenë i ndjeshëm në dhjetëvjeçarin e fundit. Penetrimi i përdoruesve të telefonisë celulare, si dhe ai i përdoruesve të internetit është rritur me shpejtësi. Numri i lidhjeve *broadband* është dyfishuar në dy vitet e fundit megjithatë mbetet ende larg synimeve dhe mesatares europiane.

Broadband ndikon ndjeshëm në mënyrën e jetesës dhe të punës së përditshme të qytetarëve. Zhvillimi i *broadband* është një faktor i rëndësishëm për rritjen ekonomike dhe zhvillimin social e kulturor të vendit tonë.

Broadband krijon zgjidhje ekonomike të rëndësishme për përdoruesit, ofruesit e shërbimeve, ofruesit e aplikacioneve të ndryshme dhe operatorët e rrjetit.

Broadband, gjithashtu, sjell përfitime të mëdha sociale pasi ai lidh konsumatorët, bizneset dhe qeveritë, si dhe lehtëson ndërveprimin shoqëror. Nëpërmjet shërbimeve *Broadband* shpërndahet informacion për individët dhe bizneset, mbështetet një qeverisje e mirë, si dhe forcohet kapitali shoqëror.

Broadband lejon kompanitë të studiojnë mundësi të reja për biznesin e tyre, të shkojnë më afër klientëve të tyre, si dhe të marrin informacion në lidhje me çmimet e tregut. Aksesi më i mirë i informacionit bën që tregjet të punojnë në mënyrë më efikase dhe të rriten të ardhurat e prodhuesve. Informacioni në lidhje me performancën e qeverisë dhe institucioneve qeveritare bën që qeveria dhe këto institucione të jenë më të përgjegjshme dhe të përmirësojnë shërbimet e tyre publike.

Duke njohur ndarjen që ekziston në vendin tonë për sa i takon ofrimit të shërbimit *broadband* në zonat urbane dhe zonat rurale, si dhe rrezikun që disa grupe shoqërore mund të humbasin përfitimet ekonomike dhe sociale që vijnë nga përdorimi i shërbimeve *broadband*, qeveria shqiptare kërkon të nxisë zhvillimin e këtyre shërbimeve, duke përcaktuar objektiva të qartë dhe të realizueshëm.

Ky dokument përcakton si vizion për zhvillimin e *broadband* në periudhën 2013-2020:

Zhvillimi i infrastrukturës dhe i shërbimeve *broadband* në të gjithë vendin për të përftuar akses në shërbimet elektronike në fusha të ndryshme, si: shëndetësi (*e-health*), edukim (*e-education*), tregti (*e-commerce*), shërbimet qeveritare (*e-government*), si dhe për të arritur përfitime të mëdha ekonomike dhe sociale për vendin tonë.

Për përmbushjen e këtij vizioni, synohet arritja e objektivave të përgjithshëm të mëposhtëm:

- përmirësimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës *broadband* në të gjithë vendin;
- rritja e penetrimit të internetit;
- ofrimi i internetit me shpejtësi dhe siguri të lartë në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar, përfshirë zonat rurale dhe zonat e thella;
- rritja e konkurrencës dhe ulja e çmimeve;
- Rritja e cilësisë së shërbimit;
- zgjerimi i numrit të shërbimeve elektronike (*e-service*) në dispozicion të qytetarëve shqiptarë dhe digjitalizimi i të gjitha shërbimeve publike;
- rritja e ndërgjegjësimit të të gjitha shtresave të shoqërisë, përfshirë dhe personat me nevoja të veçanta, lidhur me përfitimet që vijnë nga përdorimi i shërbimeve *broadband*.

Në fund të periudhës 2013-2020 do të synohet:

Arritja e shtrirjes së aksesit në mbarë vendin në mënyrë të drejtpërdrejtë për familjet, dhe bizneset apo institucionet, duke parashikuar objektivat e mëposhtëm:

- Dyfishimin e numrit të familjeve dhe kompanive, të cilat do të kenë akses në lidhjet *broadband* jo më vonë se në fund të vitit 2017;
- 100% e shkollave me të paktën një lidhje internet *broadband* në çdo klasë;
- 100% e universiteteve me lidhje internet *broadband* me shpejtësi të lartë;
- 100% e zyrave postare të ofrojnë të paktën një lidhje internet *broadband* për qytetarët.
- 100% e qendrave shëndetësore dhe spitaleve me të paktën një lidhje interneti *broadband*.
- Mundësimin e aksesit me shpejtësi të lartë transmetimi, të paktën 100 Mbps deri në 50% e familjeve dhe të paktën 30 Mbps për të gjithë shqiptarët.

Realizimi i objektivave do të bëjë që vendi ynë të arrijë nivelet e vendeve të zhvilluara, në vitet që do të vijnë, për sa i takon nivelit të ofrimit të rrjeteve/shërbimeve *broadband*.

3. Politika për të promovuar *broadband* në Shqipëri.

Për të promovuar *broadband* në Shqipëri dhe për të lehtësuar sa më shumë integrimin e të gjitha nismave që lidhen me *broadband* dhe që duhet të përfshihen në procesin e zhvillimit të tij, do të implementohen politikat e mëposhtme:

(Shfuqizuar paragrafi "Për rëndësinë strategjike që ka zhvillimi i broadband jo vetëm për sektorin, por për gjithë ekonominë e vendit për udhëheqjen e procesit do të krijohet Komisioni për Zhvillimin e Broadband nën drejtimin e Kryeministrit" me VKm nr.300, datë 8.04.201)

3.1 Koordinimi i të gjithë aktorëve

Duke njohur përfitimet e mëdha që vijnë nga TIK dhe *broadband*, qeveria shqiptare është e vetëdijshme se ajo duhet të luajë një rol të rëndësishëm në vendosjen e një bashkëpunimi midis të gjitha palëve të interesuara për zhvillimin e *broadband*.

Njësitë e qeverisjes vendore, të komunave dhe bashkive duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, me qeverinë qendrore dhe rregullatorin për të promovuar zhvillimin e infrastrukturës *broadband* me kosto sa më efektive, dhe lehtësuar ose reduktuar barrierat administrative.

Duke qenë se shumë palë të interesuara, përfshirë subjekte qeveritare, njësitë e qeverisjes vendore, si dhe sektori privat do të përfshihen në zhvillimin e *broadband* për ta bërë atë të mundur për të gjithë popullin shqiptar, qeveria konsideron se është thelbësore planifikimi i kujdesshëm i investimeve të *broadband* dhe shtrirjes së infrastrukturës. Kjo është një çështje që kërkon informacion të dhëna nga struktura të ndryshme përgjegjëse në qeveri dhe më gjerësisht nga administrata publike. Prandaj është e domosdoshme koordinimi i masave të ndërmarra nga qeveria qendrore, njësitë e qeverisjes vendore, rregullatori dhe autoritete të tjera përkatëse, përfshirë autoritetet e ngarkuara për transmetimet radiotelevizive.

Administratat e bashkive, komunave nëpërmjet rrjeteve në pronësi të tyre apo mundësimit të aksesit dhe të drejtës së kalimit për infrastrukturën e komunikimeve elektronike, kompanitë energjetike, kompanitë e ndërtimit të rrugëve dhe zyrat postare, të gjitha së bashku luajnë një rol të rëndësishëm në tregun e *broadband* në disa aspekte dhe do të jenë përgjegjëse për hartimin e projekteve të infrastrukturës lokale të teknologjisë së informacionit.

Përveç kësaj, qeveria qendrore është përgjegjëse për veprimet e nevojshme për të përmirësuar efikasitetin e administratës së saj përmes teknologjisë së informacionit dhe zotëron një rrjet qeveritar *broadband* për projektet dhe komunikimet ndërqeveritare.

Inkurajimi i praktikave të bashkinvestimit të sektorit privat dhe bashkëpërdorimit të infrastrukturës është i rëndësishëm për reduktimin e kostove dhe maksimizimin e përfitimeve si për sektorin privat ashtu dhe për konsumatorët.

AKEP është institucioni përgjegjës për krijimin e një mjedisi rregullator për sektorin publik dhe privat në zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve *broadband*. Së bashku MITIK-u dhe AKEP-i do të jenë përgjegjës për zbatimin e politikës në përgjithësi, ndërsa AKSHI do të punojë për të zhvilluar qeverisjen elektronike (*e-Government*).

Ministritë e linjës, të tilla si: Ministria e Shëndetësisë, e Arsimit, e Punës etj., gjithashtu, luajnë një rol të rëndësishëm duke mbështetur zhvillimin e përmbajtjes për shërbimet e tyre *online* dhe duke përdorur *broadband* për përmirësimin e këtyre shërbimeve.

(shfuqizuar)

Objektivi: Nxitja e bashkëpunimit midis institucioneve qeveritare dhe përcaktimi i qartë i përgjegjësive të tyre, përfshirë autoritetet lokale, rajonale (komunat/bashkitë), lidhur me zhvillimin e *broadband* në vendin tonë. Koordinimi dhe komunikimi me këto institucione lidhur me projektet e tyre respektive dhe vendimet e qeverisë, të cilat kanë ndikim në zhvillimin e TIK-ut.

Veprimet

- Krijimi i një forumi *broadband* për bashkëpunim dhe dialog për shpërndarjen dhe përdorimin e *broadband*, me pjesëmarrjen e qeverisë, sektorit privat, industrisë dhe autoriteteve lokale e rajonale.
- Përcaktimi i përgjegjësive të qarta dhe detyrimeve të organeve dhe agjencive qeveritare.
- Identifikimi i mekanizmave të koordinimit lidhur me përmbajtjen e të dhënave që vijnë nga ministritë e linjës, agjencitë publike dhe sektori privat.
- Sigurimi i koordinimit dhe i komunikimit me autoritetet e pushtetit vendor, të tilla si: bashkitë, komunat.

Institucioni përgjegjës

Komisioni për Zhvillimin e *Broadband*, Ministri i Inovacionit dhe TIK në bashkëpunim me ministritë e tjera të linjës dhe organizata të tjera

Periudha kohore: 2013 e në vijim

3.2 Krijimi i një mjedisi të favorshëm: politik, ligjor dhe rregullator

Ky komponent është një mbështetje e rëndësishme për krijimin e një mjedisi dinamik për zhvillimin e *broadband* në vendin tonë, mjedis që përfshin sektorin publik dhe sektorin privat. Për të krijuar këtë mjedis lehtësues, sektori publik do të integrojë kontributet e ardhura nga një numër institucionesh qeveritare, si: MITIK, AKEP, KKRT, ministritë e tjera të linjës, autoritetet e pushtetit vendor etj.

3.2.1 Masat ligjore dhe rregullatore për të nxitur zgjerimin e *broadband*

(Shtuar paragrafë në fund të seksionit 3.2.1, zëvendësuar periudha kohore, përcaktimi 2012-2015 me 2015-2017, me VKM nr.300, datë 8.04.2015)

Për shtrirjen e infrastrukturës dhe ofrimin e shërbimit *broadband*, ka një nevojë të madhe për investime, ndërkohë që kërkesa nga konsumatorët dhe gatishmëria për të paguar për shërbimet e ardhshme mbetet e pasigurt. Për të mbështetur investimet e nevojshme është e rëndësishme që të kemi rregullime të cilat të jenë afatgjata dhe të parashikueshme dhe që t'i japin lojtarëve të tregut një nxitje për të investuar.

Qeveria është e vetëdijshme se infrastruktura në këtë sektor do të duhet të zgjerohet dhe përmirësohet dhe për këtë do të lindë nevoja për investime të ndjeshme. Rrjetet fikse kanë nevojë të zgjerohen për të ofruar më shumë mbulim në tërë vendin dhe, gjithashtu, kanë nevojë të përditësohen për të bërë të mundur ofrimin e internetit me shpejtësi më të larta. Aktorët që ofrojnë rrjetet *ëireless* do të duhet, gjithashtu, të bëjnë investime të mëdha për të zgjeruar mbulimin e zonave me shërbim dhe ofrimin e internetit me shpejtësi të lartë dhe me cilësi të mirë. Operatorët celularë do të duhet të marrin në konsideratë një numër më të madh të lidhjeve fikse radio të fuqishme në stacionet bazë në mënyrë që të shpërndajnë internet me shpejtësi më të lartë për familjet dhe bizneset. Në këtë moment ka, gjithashtu, nevojë për shtrirjen e fibrës optike për të ofruar më shumë kapacitete në rrjetet fikse apo celulare.

Në ngjashmëri me mekanizmat që janë përdorur në përgjithësi në vendet e tjera të botës, gjatë dy dekadave të fundit, për të promovuar aksesin universal në shërbimet e zërit dhe të të dhënave bazë, qeveria shqiptare gjykon se për të zgjeruar aksesin së pari duhet të merren në konsideratë mekanizma të tjerë, përveç mekanizmave të financimit publik. Burimet publike janë të pakta, prandaj përpara se të përdorim burimet e fundme publike, duhet të analizohen dhe implementohen ashtu siç duhet të gjitha instrumentet e mundshme joinvestuese, përfshirë reformat rregullatore.

Vetëm duke krijuar mekanizmat e nevojshëm, për të lejuar lojtarët e tregut që të konkurrojnë, tregjet do të jenë në gjendje të funksionojnë në mënyrë efektive dhe sektori i TIK-ut do të jetë në gjendje të ofrojë akses në rritje në shërbimet *broadband* dhe kështu të kontribuojnë efektivisht në rritjen ekonomike, inovacionin dhe zhvillimin teknik. Kjo do të ketë një ndikim pozitiv në kuadrin në të cilin funksionojnë së bashku bizneset dhe konsumatorët, pasi masa të tilla krijojnë më shumë zgjedhje në kuptimin e furnizimit me shërbime *broadband*, si dhe ndikojnë në çmime.

Për të përmbushur objektivat dhe për t'i siguruar tregut kushtet e nevojshme për të ofruar shërbime dhe për të investuar për zhvillimin e *broadband* në të gjithë vendin, qeveria shqiptare propozon një sërë masash rregullatore, duke përfshirë rregullimet e nevojshme që lidhen me konkurrencën për të rritur tregjet efektive, përcaktimin e një strategjie për akses dhe shërbime

universale, qëllimi i së cilës është nxitja e investimeve në *broadband* në zonat më të thella dhe promovimin e strategjive të aksesit të hapur, veçanërisht kur projekte thelbësore janë subvencionuar nga qeveria.

Për të shmangur krijimin e pengesave për shtrirjen e *broadband*, do të mbahet parasysh zhdukja e barrierave administrative për ndërtimin e shpejtë të infrastrukturës,veçanërisht në ngritjen e siteve të reja celulare, ku operatorët nuk do të përballen me procedurat e shumta administrative dhe të ballafaqohen me procese të gjata miratimi. Për këtë po punohet për hartimin e instrumentit të planifikimit të infrastrukturës së komunikimeve elektronike në përputhje me përcaktimet e ligjit për planifikimin e territorit.

Gjithashtu, AKEP-i do të shqyrtojë se si brezat e frekuencave për komunikimet elektronike mund të përdoren për të rritur disponibilitetin në zonat që kanë mungesë aksesi në shërbimet *broadband* ose kanë *broadband* me kapacitet dhe cilësi të ulët.

Me zhvillimet e tregut dhe rritjen e penetrimit të *broadband* në përputhje me përcaktimet ligjore do të rishikohet përfshirja e aksesit në internetin me brez të gjerë (*broadband*) brenda detyrimit të shërbimit universal. Përveç kësaj, mund të merren masa të veçanta në trajtimin ndërmjet zonave "të zeza" (ku platforma bazë e konkurrencës ekziston dhe pritet të ofrohet shërbim i mirë *broadband*), zonave "gri" (ku të paktën një ofrues shërbimi pritet të ofrojë shërbim, megjithëse cilësia mund të jetë jo e pëlqyeshme) dhe zonave të "bardha" (ku shërbimi nuk është i disponueshëm). Në mënyrë të ngjashme me Mbretërinë e Bashkuar dhe vende të tjera europiane, burimet e investimeve qeveritare do të fokusohen në tregun e dështuar të zonave të bardha, gjithashtu, do të përcaktohen iniciativa rregullatore dhe iniciativa për investime në zonat gri, veçanërisht duke pasur parasysh sfidat gjeografike dhe problemet me densitetin dhe nivelet e varfërisë së popullsisë.

Në lidhje me aksesin në infrastrukturën pasive, në përputhje me amendimet e miratuara në ligjin për komunikimet elektronike do të promovohet aksesi i hapur. Njëkohësisht do të shikohen mundësitë e zbatimit të eksperiencave të vendeve të tjera ku në disa vende autoritetet publike zotërojnë dhe operojnë infrastrukturën pasive, ndërsa në disa vende të tjera autoriteteve publike u është krijuar hapësira ligjore të zotërojnë infrastrukturën pasive dhe t'ua japin me qira atë operatorëve privatë në kushte jodiskriminuese objektive dhe transparente.

Praktikat e mira tregojnë që një model i aksesit të hapur është konsideruar përgjithësisht si modeli i duhur për t'u përshtatur, veçanërisht kur qeveria ndërhyn në një treg tashmë të hapur për konkurrencë. Megjithëse në këtë model, autoritetet publike mund të zotërojnë infrastrukturë pasive, ajo konsiderohet si një praktikë e mirë për të lejuar ofruesit e shërbimeve të konkurrojnë për të ofruar shërbimet e tyre, duke u mbështetur në këtë infrastrukturë.

Gjithashtu, do t'i kushtohet më shumë vëmendje nxitjes së bashkëpërdorimit dhe bashkinvestimit të infrastrukturës aktive, në përputhje me rregullat e përgjithshme të konkurrencës, pasi një infrastrukturë e përbashkët mund të zvogëlojë koston e shtrirjes së shërbimeve *broadband* në zonat me densitet të ulët të popullsisë, aktualisht të pambuluara nga ndonjë teknologji e *broadband*.

AKEP-i, në zbatim të parashikimeve ligjore për heqjen e kufizimeve teknologjike për përdorimin e frekuencave, do të bëjë rishikimin e autorizimeve individuale të dhëna para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 102/2012. Heqja e kufizimeve teknologjike dhe ndryshimi i autorizimeve individuale përkatëse do të bëhen pa pagesë shtesë nga ana e mbajtësit të autorizimeve, duke i nxitur mbajtësit e autorizimeve, sipas një akti të nxjerrë nga AKEP-i, që të rritin mbulimin me shërbime *broadband* në zonat me densitet të ulët të popullsisë, si dhe të përmirësojnë cilësinë e shërbimit të ofruar.

Me qëllim shmangien e interferencave të mundshme dhe të pabarazisë në treg, heqja e kufizimeve për autorizimet e dhëna para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 102/2012, për mbajtësit e autorizimeve që kanë aplikuar pranë AKEP-it për rivlerësimin e kufizimeve të bëhet e njëkohshme nëse është e mundur.

Krahas procesit të heqjes së kufizimeve teknologjike për të bërë të mundur shfrytëzimin më të mirë të spektrit të frekuencave për zhvillimin e rrjeteve *broadband*, për interes publik dhe sipas parashikimeve ligjore, nga AKEP-i do të kryhet edhe procesi i riorganizimit të spektrit në këto breza. Riorganizimi i spektrit, përmes modifikimit të autorizimeve individuale përkatëse të dhëna në brezat 900/1800 MHz, 2100 MHz, do të kryhet pas dhënies në përdorim të spektrit të lirë të mbetur në këto breza, por jo më vonë se tre muaj nga përfundimi i procesit të dhënies në përdorim të këtyre brezave.

Politika spektrale e Bashkimit Evropian, e miratuar me vendimin 243/2012/EU, përcakton si detyrim të vendeve anëtare të BE-së sigurimin brenda vitit 2015 të një sasie spektri prej 1200 MHZ

për sistemet e avancuara IMT. Gjithashtu, studimet e ITU-së vlerësojnë që nevojat spektrale për sistemet e avancuara IMT shkojnë nga 1280 MHz në 1720 MHz. Në përputhje me politikën spektrale të Bashkimit Evropian dhe bazuar në perspektivat e zhvillimit, tendencën në rritje të trafikut të komunikimeve data si dhe zhvillimet teknologjike, do të bëhen të gjitha përpjekjet për identifikimin dhe krijimin e sasisë së spektrit të nevojshëm për zhvillimin e rrjeteve të së ardhmes.

Qeveria do të nxitë AMA-n për ndërmarrjen e veprimeve të menjëhershme për lirimin e brezit të dixhital - dividentit. Ministri, në bashkëpunim me AKEP-in dhe AMA-n, do të punojnë për reflektimin e akteve finale të ËRC-20158 në Planin Kombëtar të Frekuencave, si dhe për hartimin e ndryshimeve në aktet ligjore e nënligjore përkatëse, nëse është e nevojshme.

Objektivi. Zgjerimi i shtrirjes së infrastrukturës dhe shërbimeve *broadband* përmes rregullimeve ligjore dhe rregullatore, të cilat nxisin investimet private dhe zhvillimin e *broadband*.
Veprimet. Qeveria e Shqipërisë propozon një numër masash rregullatore për të nxitur investimet në *broadband*, duke përfshirë:

- Përcaktimin e masave për sigurimin e aksesit në të gjithë vendin që ka për qëllim nxitjen e investimeve në zona shumë të largëta, investime të cilat përfshijnë *broadband*.
- Rishikimin dhe përmirësimin e kuadrit rregullator.
- Lejimi i njësive qeveritare lokale, rajonale dhe kombëtare, për të bashkëpunuar me sektorin privat për të ndërtuar rrjete *broadband*, përfshirë partneritetet publike-private.
- Nxitjen e sinergjive (bashkëpunimit për reduktimin e kostove) ndërmjet subjekteve të ndryshëm, përfshirë kompanitë e energjisë, rrugëve dhe hekurudhave, për shtrirjen/ndërtimin e infrastrukturës *broadband* veçanërisht në zonat pa shërbim dhe zonat me pak shërbim përmes instrumenteve ligjore e rregullatore, stimujve financiarë dhe ekonomikë dhe përmes iniciativave të tjera.
- Përmirësimin, plotësimin e legjislacionit lidhur me spektrin e frekuencave dhe caktimin e tyre dhe krijimin e kushteve më të mira për ndarjen dhe tregtimin e spektrit të frekuencave.
- Dhënien në përdorim të frekuencave që mundësojnë shërbimin *broadband*.
- Lirimi i spektrit të frekuencave te "digjital dividentit" (DD) dhe nxitja e përdorimit të DD, për shërbimet *broadband*, si dhe rishpërndarja e brezave të frekuencave (*re-farming*) bazuar në parimin e teknologjisë neutrale.
- Plotësimi dhe zbatimi i kuadrit rregullator për zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve *broadband*, përfshirë rregullimet që lidhen me konkurrencën, aksesin dhe infrastrukturën.
- Lehtësimin e lejeve të ndërtimit/infrastrukturës dhe autorizimeve për të drejtën e kalimit në pronën publike dhe private.

Institucioni përgjegjës
Komisioni për Zhvillimin e *Broadband*, MITIK, AKEP, KKRT, ML, në bashkëpunim me grupet e interesit
Periudha kohore
2015-2017

3.2.2 Zgjidhjet teknologjike për *broadband*

Qeveria e Shqipërisë mbështet një politikë për teknologji neutrale dhe është e vetëdijshme se aksesi në shërbimet *broadband* mund të bëhet i mundur përmes teknologjive të ndryshme si përmes infrastrukturës me tela ose përmes rrjetit të telefonisë fikse, një rrjeti kabllor televiziv ose një rrjeti bazë të fibrës optike, ose mund të bëhet përmes një rrjeti pa tela, për shembull përmes një rrjeti valor ose satelitor, sidomos për zonat më të largëta të vendit.

Gjithashtu, qeveria është e vetëdijshme se është e nevojshme të bëhen përpjekje të posaçme dhe me një qëllim të përcaktuar, për të siguruar që ekzistojnë mundësi të njëjta në të gjithë vendin për të gjithë konsumatorët, qofshin ato familje apo biznese, duke përfshirë edhe konsumatorët në zonat rurale dhe zonat më të thella. Për këtë qëllim, qeveria nxiti AKEP-in për krijimin e atlasit për *broadband*-in, i cili është në thelb një kontroll bazë dhe AKEP do të vazhdojë të vendosë në hartë informacion mbi ofrimin e *broadband* nga operatorët ekzistues (përfshirë mbulimin e territorit, shpejtësitë dhe çmimet) dhe, gjithashtu, të përfshijë planet e investimeve në të ardhmen për rrjete të reja, zgjerim të rrjeteve ekzistuese ose përmirësim të shërbimeve.

Harta duhet të tregojë qartë zonat në të cilat nuk ka rrjete/shërbime *broadband* ekzistuese ose të planifikuara nga biznesi, nuk ka rrjete/shërbime *broadband* të menaxhuara dhe zotëruara nga qeveria, si dhe zonat në të cilat ekziston *broadband*, por që ofrohet nga një operator i vetëm dhe zonat

[8]Konferenca Boterore e Radiokomunikacionit

në të cilat ka konkurrencë të vërtetë për ofrimin e shërbimeve *broadband*.

Pas analizës së këtyre të dhënave, vihet re nevoja e ndërhyrjes publike dhe në kontekstin e kësaj ndërhyrjeje do të merren në konsideratë vlerësimet ekonomike për të zgjedhur një teknologji specifike, sidomos kur është treguar që një teknologji specifike është mënyra më efikase për të dhënë një cilësi shërbimi të caktuar. Në këtë kontekst, qeveria do të marrë në konsideratë zgjidhjet me tela dhe pa tela, përshirë fibrën optike, si dhe zgjidhjet satelitore për të arritur mbulimin e të gjithë territorit me shërbime *broadband*.

Sidoqoftë është e qartë që teknologjia do të vazhdojë të zhvillojë dhe të ndikojë në zgjidhjet teknologjike, si dhe në nevojat dhe kërkesat e përdoruesve fundorë, përshirë edhe në aspektin e shpejtësisë dhe të kapacitetit. Zhvillimet teknologjike padyshim, gjithashtu, do të influencojnë në koston e përhapjes së rrjeteve *broadband*.

Shërbimi i lëvizshëm *broadband* (*Broadband Mobile*) është një teknologji relativisht e re në shumë vende, sidomos në vendet e rajonit të Europës Juglindore (SEE region). Edhe pse nivelet aktuale të ofrimit të shërbimit *broadband* janë të ulëta, pritet që në të ardhmen shërbimi i lëvizshëm *broadband* celular të luajë një rol të rëndësishëm për zhvillimin e *broadband-it*.

Politikat që do të ndiqen:

- Promovimi i teknologjisë neutrale;
- Promovimi i bashkëvendosjes në infrastrukturë dhe shfrytëzimit të përbashkët të infrastrukturës;
- Rritja e efikasitetit ekonomik në zgjedhjen e teknologjisë bazuar në mekanizmin e ndërhyrjes publike.

Veprimet:

- AKEP-i do të plotësojë hartën e *broadband-it* (atlasin) për të treguar disponueshmërinë e lidhjeve *broadband* me pakicë, për një ose më shumë shpejtësi transmetimi të caktuar të internetit *broadband*.
- MITIK-u dhe AKEP-i do të jenë përgjegjës në grumbullimin e të dhënave në lidhje me investimet private të planifikuara.
- MITIK-u dhe AKEP-i do të bashkëpunojnë me institucionet e tjera publike për të përcaktuar dhe krijuar një regjistër të infrastrukturës civile ekzistuese, si dhe infrastrukturës alternative, përfshirë për shembull rrjetet e tjera të transportit dhe hekurudhës, si rrjetet e energjisë, ujit dhe ujërave të zeza, me qëllim për të identifikuar infrastrukturën pasive, i cili përfshirë tubat apo antenat (gropat dhe shtyllat), të cilat mund të përdoren për të "transportuar" shërbimet e komunikimeve elektronike me kosto të ulët.
- Identifikimi i kapaciteteve në pronësi të qeverisë, i cili mund të përdoret për të mbështetur shtrimin e rrjetit kombëtar *broadband*.
- AKEP-i do të jetë përgjegjës për të identifikuar të gjithë furnizuesit e mundshëm potencialë të rrjeteve dhe shërbimeve *broadband.*

Institucionet përgjegjëse

MITIK, AKEP, bashkëpunim me ML, aktorë të tjerë

Periudha kohore

2012-2015

3.2.3 Politikat për krijimin e kërkesës

Promovimi i një kërkese më të madhe për shërbime, përfshirë edhe përmes krijimit të institucioneve "*anchor*", për të promovuar përfshirjen elektronike (*e-inculsion*) të të gjithë sektorëve të popullsisë dhe të gjithë shoqërinë në të gjitha rajonet e vendit, si dhe duke ndërmarrë veprime të përcaktuara për të rritur kërkesën për shërbimet *broadband* nga të gjithë përdoruesit e tjerë, si familjet, ashtu edhe bizneset. Aksesueshmëria, përballueshmëria dhe tërheqja (atraktiviteti) do të jenë tri shtyllat bazë ku do të mbështetet qeveria në përpjekjet e saj për të rritur kërkesën e përdoruesve për shërbimet *broadband*. Përpjekjet për të rritur kërkesën do të implementohen në mënyrë graduale, ndërkohë që duke vlerësuar zhvillimet e tregut dhe mbështetjen publike do të duhet të plotësohen edhe boshllëqet e mbetura (të tilla si trajnimi për njerëzit me aftësi të kufizuara, të moshuarit ose akses për shkollat në zonat e largëta). Ndër këto përpjekje, më poshtë listojmë:

- Ngritjen në vazhdimësi të qendrave të aksesit *broadband*, teleqendrave apo pikave të tjera të aksesit publik, përfshirë edhe zyrat postare.

- Sigurimi i mbështetjes në vazhdimësi për të lidhur institucionet e arsimit dhe të kërkimeve shkencore në rrjetet *broadband*.

- Trajnimi i të gjithë qytetarëve për të aksesuar dhe përdorur shërbimet *broadband*, nëpërmjet

programeve të literaturës digjitale.

- Mbështetje lokale për përmbajtjen e internetit në gjuhën shqipe.
- Vendosjen e informacionit publik dhe qeveritar *online* dhe krijimin e qeverisjes elektronike (e-qeverisje) dhe aplikacioneve të tjera e-aplikacione (të tilla si ato të shëndetësisë, arsimit etj).
- Edukimin e qytetarëve lidhur me përfitimet që vijnë nga zhvillimi i *broadband*-it.
- Promovimi i përdorimit të *broadband*-it nga bizneset dhe komunitetet përmes programeve dhe fushatave të ndërgjegjësimit, si dhe nëpërmjet programeve të subvencioneve për konsumatorët.
- Mbështetja e krijimit të qendrave të inovacionit ose qendrave për të inkurajuar zhvillimin e përmbajtjes dhe aplikacioneve për përdorim në Shqipëri.
- Disponueshmëria e pajisjeve *broadband* dhe aksesit të internetit në shkollat për zhvillimin e trajnimit të mësuesve dhe përmbajtjes elektronike të mësimit, e-mësimi (*e-learning*).

Qeveria e Shqipërisë është e vetëdijshme se kur njësitë qeveritare në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar përcaktojnë politikat që duhet të ndërmarrin, ato, gjithashtu, bëhen edhe vetë përdoruesit kryesorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike (për shembull, përmes lidhjes së shkollave në internet dhe projekteve të tjera në lidhje me arsimin, përdorimit të infrastrukturës qeveritare ose projekteve të rrjeteve intranet, prokurimeve elektronike, taksave *online* dhe arkivave publike).

Qeveria beson se duke rritur më tej kërkesën e qeverisë për shërbime *broadband*, mund të nxitet rritja e kërkesës për këto shërbime dhe të ulet rreziku i investimeve të biznesit. Në këtë kontekst, hapi i parë i rëndësishëm është përcaktimi i të gjithë përdoruesve kryesorë të shërbimeve të TIK-ut të financuar nga qeveria, përfshirë shkollat, spitalet, zyrat postare, si dhe qendrat e shërbimit publik në mënyrë që ato të njohin dhe të kuptojnë prioritetet e tyre dhe qëllimin e bashkëpunimit.

Qeveria e Shqipërisë do të ndërmarrë masa të tjera të mëtejshme për të nxitur ndërgjegjësimin dhe rritjen e kërkesës për shërbimet *broadband*, në mënyrë të veçantë përmes programeve të ndërgjegjësimit *e-literatura*, programeve të përcaktuara të marketingut dhe projekteve e programeve institucionale në vazhdimësi, si: e-qeverisja, ofrimi i shërbimeve *broadband* në ambiente publike, si shkollat dhe qendrat shëndetësore, futjen e aplikacioneve elektronike (e-applications), të tilla si e-shëndetësi dhe e-edukim, përcaktimin e kërkesave dhe dispozitave përkatëse për personat me nevoja të veçanta, si personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, gratë dhe të moshuarit.

Qeveria, gjithashtu, do të marrë në konsideratë edhe përdorimin e subvencioneve qeveritare, si dhe aplikimin e tarifave të ulëta ose të zgjedhura për të rritur kërkesën, veçanërisht në zonat rurale dhe zonat më të thella dhe për grupet e popullsisë me të ardhura më të ulëta.

Në këtë kontekst qeveria do të punojë me autoritetet qeveritare vendore dhe organizata te tjera që në mënyrë aktive të nxisë mesazhin se ekonomitë dhe komunitetet që nuk janë në gjendje për të shfrytëzuar plotësisht përfitimet e TIK-ut, ka pak të ngjarë që të mbeten të qëndrueshme ose të bëjnë një tranzicion të suksesshëm në ekonomi/shoqëri të bazuar në njohuritë.

Qeveria, gjithashtu, do të punojë me AKEP-in, si dhe me autoritetet lokale, rajonale dhe kombëtare për t'i sensibilizuar këto autoritete lidhur me nevojën për zhvillime të reja, për të arritur standardet e duhura për sa u përket rrjeteve/tubacioneve.

Objektivi: Rritja e kërkesës për *broadband* përmes iniciativave elektronike (e-qeverisje, e-shëndetësia, e-edukim, e-taksa etj.).

Veprimet:

MITIK, AKSHI do të jenë përgjegjës për të identifikuar/përcaktuar të gjithë përdoruesit e mundshëm të shërbimeve me bandë më të gjerë, të financuar nga qeveria, përfshirë shkollat, spitalet dhe qendra të tjera publike brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2013.

Zhvillimi i shërbimeve që kërkojnë *broadband*:

- Të punohet me Ministrinë e Shëndetësisë për të zhvilluar më tej shërbimet elektronike shëndetësore, e – *health*, MITIK-u dhe Ministria e Shëndetësisë;
- Të punohet me Ministrinë e Arsimit për të ndihmuar universitetet lokale për të zhvilluar më tej shërbimet e mësimdhënies elektronike (*e-teaching*), MITIK-u dhe Ministria e Arsimit;
- Të punohet me Ministrinë e Arsimit për krijimin e kuadrit për zhvillimin e programeve/*softëare;*
- Të punohet me Ministrinë e Financave për të zhvilluar më tej e-taksat, MITIK dhe Ministria e Financave;
- Të punohet me doganat për të zhvilluar më tej procedurat doganore elektronike, MF, MITIK dhe

doganat;

- Të punohet me zyrat postare për të zhvilluar më tej pikat e aksesit MITIK dhe Posta Shqiptare.

Përcaktimi i kërkesave dhe dispozitave për personat me nevoja të veçanta (personat me aftësi të kufizuara, të rinj, gra, të moshuar etj.) MITIK-u në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Përdorimi i subvencioneve të qeverisë për programe të veçanta për shkollat, librarit dhe institucione të tjera "anchor" MITIK-u në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Ministrinë e Arsimit dhe institucionet përkatëse.

Aplikimi i tarifave të ulëta ose preferenciale për institucionet "anchor", si dhe përdoruesit individualë për të rritur kërkesën AKEP në bashkëpunim me aktorët e tjerë.

Nxitja e krijimit të përmbajtjes në gjuhën shqipe.

Marketingu i përdorimit të *broadband* në rajonet dhe komunat përmes një fushate ndërgjegjësimi për TIK-un dhe ngritjen e programeve sensibilizuese për e-literaturën dhe digjitalizimin MITIK së bashku me AKEP, AKSHI, Ministria e Brendshme

Komisioni për Zhvillimin e *Broadband*

3.3 Shtrirja e infrastrukturës *broadband*

Shtrirja dhe zgjerimi i infrastrukturës dhe shërbimeve *broadband* kërkon kontributin e rëndësishëm të sektorit privat, ku përfshihen një sërë operatorësh të shërbimit fiks, shërbimit të lëvizshëm, si dhe ofrues të shërbimit të internetit të cilët janë aktivë në tregun shqiptar që kanë kontribuar në ndërtimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike dhe ofrimin e shërbimeve. Zbatimi i këtij plani dhe arritja e synimeve, objektivave specifikë për sigurimin e aksesit *broadband* me shpejtësi të lartë në të gjithë vendin përfshirë dhe zonat e largëta, kërkon më shumë investime nga sektori privat. Roli i qeverisë do të jetë kryesisht në krijimin e klimës së përshtatshme për investime, në rritjen e kërkesës, rritjen e ndërgjegjësimit për shërbimet *broadband*, nxitje të kooperimit dhe sinergjive midis aktorëve, si dhe zhvillimin e modeleve të partneritetit publik e privat, pa dëmtuar konkurrencën e ndershme në treg.

Qëllimi është që shumë nga masat e sugjeruara të mund të zvogëlojnë nevojën e ndërhyrjes publike përmes buxhetit të shtetit duke krijuar një mjedis ku shtrirja e *broadband*-it të mund të arrihet përmes zgjerimit të rrjeteve/shërbimeve dhe ngritjes së rrjeteve/shërbimeve të reja nga operatorët (përmes licencimit) ose të financohet nga kontributet e industrisë së komunikimeve elektronike, si dhe me iniciativa të tjera të cilat të jenë të vetëqëndrueshme nga tarifat e shërbimeve (si me programet e-qeverisje) ose iniciativa që zvogëlojnë koston e shtrirjes së rrjeteve *broadband* (si me përdorimin e përbashkët të infrastrukturës).

Për të arritur qëllimet dhe objektivat e mësipërm, do të punohet, gjithashtu, për të siguruar qëndrueshmëri të pikave të aksesit publik të ngritura nga zyrat postare, si dhe për shtimin e pikave të reja aksesi publik, për zhvillimin e modeleve të financimit për të gjetur burime të ardhurash që do të siguronin qëndrueshmëri afatgjatë. Do të shtohet numri i kompjuterëve, si dhe lidhjet e internetit *broadband* në shkolla, duke siguruar mirëmbajtjen dhe qëndrueshmërinë e tyre.

3.4 Aplikacionet dhe pasurimi i përmbajtjes *online*

Rëndësia e shërbimeve *broadband* ka ardhur si pasojë e zhvillimit të një sërë aplikacioneve me vlerë të shtuar, përfshirë shërbimet qeveritare, si edukimi, shëndetësia, regjistri i biznesit, shërbime që lidhen me taksat etj. Kjo rëndësi, gjithashtu, i është dhënë edhe nga sektori privat përmes aplikacioneve, të tilla si ato që lidhen me turizmin dhe aftësinë për të mbështetur transaksionet, mbështetjes për transaksionet financiare elektronike brenda vendit, si: bankat, tregtia elektronike etj.

Objektivat, synimet afatgjata dhe masat që do të ndërmerren në lidhje me aplikacionet dhe përmbajtjen synojnë rritjen e numrit të shërbimeve elektronike të disponueshme për qytetarët e Shqipërisë dhe së fundi digjitalizimin e të gjitha shërbimeve publike.

Ndër çështjet më kryesore në vëmendje të qeverisë janë:

- Krijimi i strukturës së hostimit të shërbimeve *cloud* në sektorin publik (*cloud services hosting facility*) për të forcuar qeverinë shqiptare nëpërmjet ofrimit të shërbimeve për qeverinë, biznesin dhe qytetarët.

- Të koordinojë me sektorin privat për të krijuar strukturën e hostimit të shërbimeve *cloud* dhe për të nxitur zhvillimin e aplikacioneve me vlerë të shtuar dhe përmbajtjes së tyre nga sektori privat, për zgjerimin e mundësive social-ekonomike në Shqipëri.

- Të koordinojë zhvillimin e tregtisë elektronike të sektorit privat me qëllim mbështetjen e biznesit shqiptar dhe komunitetin bankar.

- Të koordinojë zhvillimin e aplikacioneve të sektorit privat dhe përmbajtjes në gjuhën shqipe.

- Krijimi i portalit kombëtar, për të bërë lehtësisht të mundur informimin e sektorit publik dhe privat për çështje që lidhen me qeverinë, biznesin, qytetarët dhe turistët.

- Të studiojë mundësinë e krijimit të një nëngrupi brenda portalit kombëtar për të nxitur dhe mbështetur turizmin në Shqipëri, duke përfshirë sigurimin e informacionit dhe mundësinë për të bërë rezervime, si dhe për të ndërmarrë transaksione financiare.

- Disponueshmëria e kompjuterëve, aksesit të internetit dhe shërbimeve *broadband* në shkolla për zhvillimin e trajnimit të mësuesve dhe përdorimit të përmbajtjes së mësimit elektronik (*e-learning*).

3.5 Përdorimi i *broadband* nga sektori publik, biznesi dhe qytetarët

Me rëndësi social-ekonomike, që vjen si pasojë e infrastrukturës së zgjeruar, aplikacioneve me vlerë të shtuar dhe përmbajtjes, është edhe miratimi dhe përdorimi gjithandej i kësaj përmbajtjeje, nga sektori privat dhe publik, përfshirë nivelet institucionale dhe qytetare.

Objektivi është rritja e ndërgjegjësimit lidhur me përfitimet që vijnë nga përdorimi i shërbimeve të TIK-ut përmes *broadband* në të gjitha shtresat e shoqërisë, duke përfshirë edhe personat me nevoja të veçanta.

Çështjet kryesore në vëmendje të qeverisë shqiptare do të jenë:

- Ndërmarrja e iniciativave të sektorit publik dhe privat për të siguruar përballueshmëri të aksesit të internetit, përmes shërbimeve *broadband* me parapagim, pikave të aksesit me kosto të ulët etj.

- Të studiojë krijimin e mundësive të blerjes të kompjuterëve me kosto të ulët, mbështetur nga furnitorë (*carrier*), përmes faturimit mujor dhe programeve specifike për zhvillimin e *broadband*.

- Disponueshmëria e kompjuterëve, aksesit internet dhe shërbimeve *broadband* në shkolla për zhvillimin e trajnimit të mësuesve dhe përdorimin e përmbajtjes së mësimit elektronik (*e-learning*).

4. Modelet e financimit për zbatimin e planit kombëtar *broadband*

Aktivitetet aktuale në fushën e TIK-ut dhe për zhvillimin e *broadband* në veçanti janë financuar në përgjithësi përmes investimeve të sektorit publik dhe privat, nga qeveria dhe autoritetet lokale, si dhe nga operatorët fiks dhe të lëvizshëm, operatorët alternativë, operatorët kabllorë, shërbimet/utilitetet dhe partneritetet publike-private. Një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e sistemeve të informacionit dhe shërbimeve përmes TIK-ut kanë dhënë dhe donatorët e huaj.

Interesat e të gjithë këtyre aktorëve duhet të jenë të balancuara, dhe në të njëjtën kohë duhet të fokusohemi në nevojën për të arritur objektivat e vendosur për zhvillimin e rrjeteve/shërbimeve *broadband*.

Përveç liberalizimit të tregut, qeveria e Shqipërisë është duke punuar për zhvillimin e përshtatjen e instrumenteve rregullatore që synojnë rritjen e investimeve. Një vëmendje më e madhe duhet për rritjen e aksesit në infrastrukturën e komunikimeve elektronike në zonat rurale me kosto të lartë dhe zonat me të ardhura ekonomike të ulëta.

Ndër masat që do të ndërmerren, të cilat mund të jenë specifike ose të kombinuara, do të përmendim:

- Zhvillimin e udhëzimeve të politikës miqësore të investimeve (përfshirë, p.sh., transparencën, zbatueshmërinë dhe iniciativat për investime).

- Reduktimin dhe/ose heqjen e ndonjë tatimi të veçantë për komunikimet elektronike;

- Mekanizmat e shtetit dhe metodat e kontrolluara duke përdorur subvencionet dhe mekanizma të tjerë financimi;[9]

- Metodat e tjera të financimit dhe iniciativat e projekteve nga qeveritë lokale, shtetërore dhe kombëtare, bashkëpunime, organizata joqeveritare apo operatorët privat për të ngritur programe që synojnë zgjerimin e mbulimit me shërbim në zonat rurale me kosto të lartë dhe rritjen e kërkesës së konsumatorëve me të ardhura të ulëta;

- Përfshirë mundësinë e financimit në të ardhmen nga Fondi i Shërbimit Universal për të siguruar subvencione të pjesshme për programe që synojnë kryesisht të nxisin sektorin privat për ofrimin e infrastrukturës në zonat rurale ose zonat pa shërbim;

Qeveria, duke pasur parasysh se arkitektura e rrjetit *broadband* përbëhet nga lidhja ndërkombëtare, rrjeti i brendshëm *backbone* dhe rrjeti i aksesit të pajtimtarit, vlerëson se ndërtimi i

[9] State-mandated and controlled approaches using cross subsidies and other financing mechanisms;

rrjeteve *backbone* të brendshëm dhe ndërtimi i lidhjeve ndërkombëtare janë thelbësore për të siguruar cilësi të lartë dhe lidhje interneti me kosto të ulët brenda dhe jashtë vendit.

Ndërtimi i një rrjeti qeveritar kombëtar *backbone* bën të mundur lidhjen midis agjencive dhe institucioneve kryesore, si dhe ofron infrastrukturën e cila mund të plotësojë dhe realizojë elementet e rrjetit komercial të pajtimtarit. Në këtë kontekst, Qeveria është duke konsideruar dhënien me koncesion, një kompanie ose një bashkimi të kompanive, për të krijuar, instaluar, zhvilluar dhe menaxhuar infrastrukturën e rrjetit kombëtar *broadband* në Republikën e Shqipërisë përmes modelit të partneritetit publik-privat.

Qeveria Shqiptare do të jetë një nga përdoruesit e kësaj infrastrukture, duke përfituar shërbime mbështetëse të komunikimeve për institucionet shtetërore, në përputhje me shërbimet e rrjetit qeveritar. Ofertuesi fitues nuk do të dublojë shërbimet ekzistuese, përveç nëse kjo do të ishte e favorshme për arsye teknike dhe komerciale dhe ndërkohë duhet të marrë të gjitha licencat e nevojshme, përfshirë autorizimet individuale për përdorimin e frekuencave, si dhe të drejtën e kalimit për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike në tregun shqiptar. Gjithashtu, do të promovohet aksesi i hapur në këtë rrjet, në mënyrë që t'u ofrojë operatorëve ekzistues zgjidhje shtesë për zgjerimin e infrastrukturës së tyre *broadband* në të gjithë vendin.

Qeveria e Shqipërisë është e vetëdijshme se duhet bërë një zgjedhje në aspektin e përcaktimit të burimeve të financimit, si dhe zgjedhjen e instrumenteve financiarë. Instrumentet financiare mund të përfshijnë kredi individuale, kredi të ndërmjetësuar, instrumente të strukturuara financiare (*structured finance facilities*), bashkëfinancimi (*risk sharing finance facilities*) ose garanci. Natyrisht zgjedhja e instrumenteve do të varet, gjithashtu, në disponueshmërinë e fondeve, të cilat mund të sigurohen nga sektori publik ose privat ose kombinim i investimeve të sektorin publik dhe privat.

Sikurse sugjerohet nga Komisioni Europian në udhëzimin e tij të vitit 2011, lidhur me Modelet e Investimit të *Broadband*[10], duhet të përdoret një kombinim i përshtatshëm i modeleve të investimit nga aktorë të ndryshëm, në mënyrë që ky model investimi të jetë në gjendje të përputhet me nevojat e aktorëve dhe të japë një zgjidhje afatgjatë për përdoruesit fundorë. Investimet e sektorit privat mund të vijnë nga brenda dhe jashtë sektorit të komunikimeve elektronike dhe mund të përfshijnë fonde nga operatorët e komunikimeve elektronike, operatorët radiotelevizivë, ofruesit e shërbimit internet, investitorë institucionalë, shërbimet utilitare, përdoruesit fundorë, ofruesit e aplikacioneve dhe përmbajtjeve ose prodhuesit/furnizuesit e pajisjeve.

Në aspektin e zgjedhjes së modelit të investimeve, janë të mundshme një sërë opsionesh. Vihet re se modelet afatgjata punojnë më mirë për financimin e infrastrukturës me shpejtësi të lartë, të tilla si infrastrukturat pasive ose infrastruktura *backhaul*, të cilat janë në dispozicion për një numër të gjerë të ofruesve të shërbimeve dhe për më tepër modelet afatgjata shihen të jenë më efektive në nxitjen e konkurrencës dhe ofrimin e shërbimeve me çmime të ulëta dhe cilësi më të mirë për përdoruesit fundorë.

Edhe pse qeveria e Shqipërisë do të marrë në konsideratë përfitimet që do të kenë përdoruesit fundorë për periudha afatgjata si një kriter kryesor për të bërë këtë zgjedhje, sikurse parashikohet në udhëzuesin e shtatorit 2011 të Komisionit Europian mbi modelet e investimeve *broadband*, qeveria, gjithashtu, pranon se mund të jenë të mundshme modele të tjera dhe se të gjitha opsionet duhet të analizohet në mënyrë që të ofrojnë zgjidhjen më të mirë për Shqipërinë.

Qeveria, gjithashtu, do të shqyrtojë metoda të tjera për të rritur fluksin e kapitalit privat në projektet e zhvillimit dhe shtrirjes së *broadband*. Qeveria do të nxisë përdorimin e instrumenteve të reja financiare sikurse sugjerohet në Dokumentin e Stafit të Punës së Komisionit Europian të vitit 2012 mbi Zbatimin e Planit Kombëtar të *Broadband*.

Veprimet

Krijimi i instrumenteve për të siguruar mbështetje financiare dhe nxitur investimet për ndërtimin dhe përdorimin e rrjeteve/shërbimeve *broadband*, duke përfshirë:

- Identifikimi dhe përcaktimi i kostos për implementimin e zgjidhjeve teknologjike për të përmbushur objektivat.
- Identifikimi i të gjitha burimeve të mundshme të fondeve - duke përfshirë grantet, kredi, te ardhurat e pritshme (*future revenue streams*) dhe madje edhe partneret në kontribute- dhe krijimi i një plani financiar për vendin.
- Konsiderimi i krijimit të rrjetit *broadband-it* kombëtar përmes PPP, subjekt i detyrimeve për akses të hapur.

[10] Në shtojcën 3 jepet një përmbledhje e modeleve të financimit të broadband në BE.

Institucioni përgjegjës
Komisioni për Zhvillimin e *Broadband*
Periudha kohore
2012-2015

Sikurse prezantohet më sipër, zbatimi i Planit Kombëtar të *Broadband* përfshin një numër të madh aktorësh. Gjithashtu, drejtimet e politikave ku do punohet janë të gjera; ato përfshijnë nga zhvillimet në infrastrukturë për sigurimin e aksesit *broadband*, në zhvillimet e aplikacioneve dhe shërbimeve elektronike, në masat për rritjen e kërkesës dhe padyshim krijimin e kuadrit të nevojshëm ligjor e rregullator, si dhe forcimin e kapaciteteve insitucionale.

Në shtojcën 2 të këtij dokumenti jepet një kostim i pjesshëm për periudhën afatmesme për zbatimin e këtij dokumenti mbi bazën e projekteve që janë të parashikuara nga institucionet në Planin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2013-2015. Në kostimin e paraqitur përfshihen investimet për sigurimin e aksesit *broadband* me shpejtësi 100 Mbit/s në administratën publike përmes GovNET, investimet për zhvillimin e shërbimeve elektronike në disa sektorë të rëndësishëm, dhe ato përmes portalit ëëë.e-albania.al, parashikimet për e-edukimin dhe projektin e-health. Nga Ministria e Arsimit është bërë dhe kostimi afatmesëm, afatgjatë për realizimin e lidhjes *broadband* të internetit në 1945 shkolla dhe në çdo klasë.

Sikurse prezantohet më lart, ky dokument do të pasohet me hartimin e një plani financiar për realizimin e objektivave afatgjatë dhe përfshirjen e kontributit të gjithë aktorëve, e cila do jetë objekt i rishkimit periodik në kuadër të hartimit të PBA-ve nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Plani, ashtu dhe në kuadër të projekteve të IPAs dhe financimeve nga donatorë të tjerë.

(Zëvendësuar paragrafi i parë me VKM nr.300, datë 8.04.2015)

5. Mekanizmi i implementimit, monitorimit dhe vlerësimit

Procesi i implementimit të këtij dokumenti do të udhëhiqet në nivel vendimmarrjeje nga Komisioni për Zhvillimin e *Broadband*-it, i kryesuar nga Zëvendëskryeministri, me nënkryetar ministrin përgjegjës për komunikimet elektronike, i cili duhet të ketë në përbërje ministrat e përmendur në këtë dokument. Në këtë Komision do të ftohen të marrin pjesë kryetarët e organeve rregullatore që veprojnë në fushën e komunikimeve elektronike. Komisioni do të ndjekë në vijimësi procesin e implementimit dhe arritjen e objektivave për zhvillimin e *broadbandit*.

Nga pikëpamja operacionale do të ngrihet sekretariati teknik, me përfaqësues të institucioneve, i cili do të luajë rolin e koordinatorit midis të gjithë aktorëve të përfshirë në zhvillimin e *broadband*. Sekretariati teknik do të zhvillojë komunikime periodike me forumin për *broadband*, si dhe do raportojë periodikisht mbi ecurinë e procesit dhe sugjerimet e dhëna nga forumi te Komisioni.

Ministritë, departamentet dhe autoritetet lokale do të përcaktojnë personat përgjegjës, të ngarkuar për realizimin e detyrave dhe objektivave të përcaktuar në këtë dokument. Ministritë përgjegjëse dhe administrata publike lokale do të bashkëpunojnë me shoqërinë civile dhe sektorin privat. Implementimi i disa aktiviteteve të planin të veprimit mund t'u delegohen organizatave joqeveritare.

Institucionet përgjegjëse për aktivitetet dhe politikat e përcaktuara në këtë dokument do të raportojnë periodikisht pranë Komisionit për Zhvillimin e *Broadbandit* mbi statusin e realizimit të tyre dhe sekretariati teknik do të jetë koordinatori.

Duke u bazuar në këto raportime, si dhe në treguesit statistikorë, do të bëhet vlerësimi i progresit drejt arritjeve të objektivave të vendosur. Bashkëlidhur këtij dokumenti paraqitet plani i veprimit afatmesëm për aktivitetet që do ndërmerren me miratimin e këtij dokumenti. Ky plan do jetë subjekt rishikimi periodik.

Treguesit për monitorimin e zhvillimit të *broadband* në Shqipëri do të përfshijnë:

- Rritja e aksesit në rrjetet/shërbimet *broadband* (numri i pajtimtarëve dhe përdoruesve, shkalla e penetrimit të *broadband*, përqindja e rritjes së penetrimit).
- Zgjerimi i zonës së mbulimit me shërbime *broadband* (zonat e mbuluara nga këto shërbime).
- Rritja e konkurrencës (konkurrenca në aspektin e sektorëve me pakicë dhe shumicë).
- Reduktimi i çmimeve të shërbimeve *broadband* (duke i ndarë për qytetet e mëdha dhe zonat më pak të zhvilluara).

- Rritja e cilësisë së shërbimeve *broadband* (duke parë ankesat dhe vlerësimet e konsumatorëve).

- Rritja e numrit të shërbimeve *broadband*, rritja e numrit të aplikacioneve dhe përdorimit të tyre (ndikimin e përdorimit të *broadband* në aktivitetet *online* të përdoruesve *broadband*, përdorimin e teknologjive të internetit dhe rritjen e të dhënave të shkarkuara nga interneti).

- Rritjen e përdorimit të *broadband* në edukim dhe kërkime shkencore (do të matet nga përdorimi i *broadband* në shkollat e mesme, profesionale dhe sektorët e trajnimit.

- Rritja e përdorimit të *broadband* në shëndetësi (përdorimi i *broadband* nga praktikantët, specialistët dhe spitalet).

- Rritja e përdorimit të *broadband* për të ofruar shërbime qeveritare (do të matet nga përdorimi i *broadband* nga institucionet qeveritare dhe aksesimi i faqeve zyrtare të institucioneve nga përdoruesit).

- Rritja e përdorimit të *broadband* nga bizneset (nga numri i punonjësve që përdorin broadband).

- Rritja e përdorimit të *broadband*-it nga komuniteti (popullsia).

SHTOJCA 1: PLANI AFATMESËM PËR ZBATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË *BROADBAND*-IT

Fusha e veprimeve	Objektivat	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse
Koordinimi i të gjithë aktorëve	Vendosja e një bashkëpunimi midis të gjithë palëve të interesuara për zhvillimin e *broadband*-it	- Krijimi i një Forumi *Broadband* për Bashkëpunim dhe Dialog për shpërndarjen dhe përdorimin e *broadband* me pjesëmarrjen e qeverisë, sektorit privat, industrisë dhe autoriteteve lokale e rajonale. - Identifikimi i mekanizmave të koordinimit lidhur me përmbajtjen e të dhënave që vijnë nga ministritë e linjës, agjencitë publike dhe sektori privat. - Sigurimi i koordinimit dhe komunikimit me autoritetet e pushtetit vendor si bashkitë, komunat. - Vlerësimi dhe monitorimi i zbatimit të Planit Kombëtar të *Broadband*	Komisioni për Zhvillimin e *Broadband* MITIK Ministritë e linjës Organizata të tjera
Krijimi i një mjedisi të favorshëm: politik, ligjor dhe rregullator	Zgjerimi i shtrirjes së infrastrukturës dhe shërbimeve *broadband* përmes rregullimeve ligjore dhe rregullatore të cilat nxisin investimet private dhe zhvillimin e *broadband*	- Përcaktimi i masave për sigurimin e aksesit në të gjithë vendin me qëllim nxitjen e investimeve në zona të largëta, investime të cilat përfshijnë *broadband.* - Rishikimi dhe përmirësimi i kuadrit rregullator. - Lejimi i njësive qeveritare lokale, rajonale dhe kombëtare, për të bashkëpunuar me sektorin privat për të ndërtuar rrjete *broadband*, përfshirë partneritetet publike-private. - Nxitjen e sinergjive (bashkëpunimit për reduktimin e kostove) ndërmjet subjekteve të ndryshme, përfshirë kompanitë e energjisë, rrugëve dhe hekurudhave për shtrirjen e infrastrukturës veçanërisht në zonat pa shërbim dhe zonat me pak shërbim, përmes instrumenteve ligjor e rregullator, stimujve financiarë dhe ekonomik dhe përmes iniciativave të tjera. - Përmirësimi, plotësimi i legjislacionit lidhur me spektrin e frekuencave dhe caktimin e tyre dhe krijimin e kushteve më të mira për ndarjen dhe tregtimin e spektrit të frekuencave. - Dhënia e autorizimeve për përdorimin e *frekukencave* që mundësojnë *broadband.* - Lirimi i spektrit të frekuencave të “digjital dividentit” (DD) dhe nxitja e përdorimit të DD, për shërbimet *broadband* , si dhe rishpërndarja e brezave të frekuencave (re-farming) bazuar në parimin e teknologjisë neutrale. - Plotësimi dhe zbatimi i kuadrit rregullator për zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve *Broadband*, përfshirë rregullimet që lidhen me konkurrencën, aksesin dhe infrastrukturën. - Lehtësimin e lejeve të ndërtimit/infrastrukturës dhe	MITIK AKEP KKRT Ministritë e linjës Grupet e interesit

		autorizimeve për të drejtën e kalimit në pronën publike dhe private.	
	Të bëhen zgjidhjet e duhura teknologjike në mënyrë që të jenë sa më efektive nga pikëpamja ekonomike	- Promovimi i teknologjisë neutrale dhe bashkëvendosjes në infrastrukturë për shfrytëzimin e përbashkët të saj. - Plotësimi i hartës së *Broadband* (ATLAS) për të treguar disponueshmërinë e lidhjeve *broadband* me pakicë për një ose më shumë shpejtësi transmetimi të caktuar të internetit *broadband*. - Grumbullimi i të dhënave në lidhje me investimet tregtare të planifikuara nga operatorët. - Krijimi i një regjistri të infrastrukturës civile ekzistuese, si dhe infrastrukturës alternative, përfshirë rrjetet e tjera të transportit dhe hekurudhës si rrjetet e energjisë, ujit dhe ujërave të zeza me qëllim për të identifikuar infrastrukturën pasive përfshirë tubat apo antenat (gropat dhe shtyllat), të cilat do mund të përdoren për të "transportuar" shërbimet e komunikimeve elektronike me kosto të ulët. - Përcaktimi i kapaciteteve në pronësi të qeverisë të cilët mund të përdoren për të mbështetur shtrimin e rrjetit kombëtar *broadband*. - Identifikimi i të gjithë furnizuesve të mundshëm potencial të rrjeteve dhe shërbimeve *broadband*.	MITIK AKEP Bashkëpunim me ministritë e linjës Aktorë të tjerë të interesuar
	Rritja e kërkesës për *broadband* përmes iniciativave elektronike (e-qeverisje, e-shëndetësi, e-edukim, e-taksa etj.)	Identifikimi/përcaktimi i gjithë përdoruesve të mundshëm të shërbimeve me bandë të gjerë, të financuar nga qeveria, përfshirë shkollat, spitalet dhe qendra të tjera publike. Zhvillimi i mëtejshëm i shërbimeve elektronike shëndetësore (e-health). - Zhvillimi i mëtejshëm i shërbimeve të mësimdhënies elektronike (e-teaching). - Zhvillimi i mëtejshëm i shërbimeve elektronike e-taksa. - Zhvillimi i mëtejshëm i procedurave doganore elektronike. - Ngritja e pikave të reja të aksesit publik. Përcaktimi i kërkesave dhe dispozitave për personat me nevoja të veçanta (personat me aftësi të kufizuara, të rinj, gra, të moshuar etj). - Dhënia e subvencioneve qeveria për programe të veçanta për shkollat, libraritë dhe institucione të tjera përgjegjës. - Aplikimi i tarifave të ulëta ose preferenciale për institucionet "anchor", si dhe përdoruesit individual për të rritur kërkesën. - Nxitja e krijimit të përmbajtjes në gjuhën shqipe. - Marketingu i përdorimit të *broadband* në rajone dhe komuna përmes një fushate ndërgjegjësimi për TIK dhe ngritjen e programeve sensibilizuese për e_literaturën dhe digjitalizimin.	MITIK AKSHI AKEP Ministritë/institucionet/Agjencitë dhe strukturat e tjera të përmendura

Ndërtimi i *broadband*	Përmirësimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës së *Broadband*, rritja e penetrimit të internetit, internet i shpejtë, i sigurt dhe me cilësi, rritja e konkurrencës dhe ulja e çmimeve	- Krijimi i klimës së favorshme për nxitjen e investimeve të sektorit privat për zhvillimin e *broadband*. - Sigurimi i qëndrueshmërisë së pikave të aksesit publik të ngritura nga zyrat postare, si dhe shtimi i pikave të reja të aksesit publik. - Zhvillimi i modeleve të financimit për të gjetur burime të ardhurash të cilat do të siguronin qëndrueshmëri afatgjatë. - Shqyrtimi i numrit të kompjuterëve, si dhe lidhjet e internetit *broadband* në shkolla lidhur me mirëmbajtjen dhe qëndrueshmërinë e tyre.	Komisioni për Zhvillimin e BB MITIK AKEP Bashkëpunimi me aktorët e tregut Ministria e Arsimit
Aplikacionet dhe pasurimi i përmbajtjes *online*	Rritja e numrit të shërbimeve elektronike në dispozicion të qytetarëve dhe digjitalizimi i të gjitha shërbimeve publike	- Krijimi i strukturës së *hostimit* të shërbimeve *cloud* në sektorin publik, (*cloud services hosting facility*) - Koordinim me sektorin privat për të krijuar strukturën e *hostimit* të shërbimeve *cloud* dhe për të nxitur zhvillimin e aplikacioneve me vlerë të shtuar dhe përmbajtjes së tyre nga sektori privat. - Koordinim për zhvillimin e tregtisë elektronike të sektorit privat me qëllim mbështetjen e biznesit shqiptar dhe komunitetin bankar. - Koordinim për zhvillimin e aplikacioneve të sektorit privat dhe përmbajtjes në gjuhën shqipe. - Krijimi i Portalit Kombëtar, për të bërë lehtësisht të mundur informimin e sektorit publik dhe privat për çështje që lidhen me qeverinë, biznesin, qytetarët dhe turistët. - Studimi i mundësisë së krijimit të një nëngrupi brenda Portalit Kombëtar për të nxitur dhe mbështetur turizmin në Shqipëri, duke përfshirë sigurimin e informacionit dhe mundësinë për të bërë rezervime, si dhe për të ndërmarrë transaksione financiare. - Disponueshmëria e kompjuterëve, aksesit të internetit dhe shërbimeve *broadband* në shkolla për zhvillimin e trajnimit të mësuesve dhe përdorimit të përmbajtjes së mësimit elektronik (*e-learning*).	MITIK AKSHI Sektori privat Ministria e Arsimit
Përdorimi i *broadband*-it nga sektori publik, biznesi dhe qytetarët	Rritja e ndërgjegjësimit lidhur me përfitimet nga përdorimi i shërbimeve të TIK përmes *broadband* në të gjitha shtresat e shoqërisë, duke përfshirë edhe personat me nevoja të veçanta	- Ndërmarrja e iniciativave të sektorit publik dhe privat për të siguruar përballueshmëri të aksesit, përmes shërbimeve broadband me parapagim, pikave të aksesit me kosto të ulët etj. - Studimi i krijimit të mundësive për blerjen e kompjuterëve me kosto të ulët ose përmes faturimeve mujore. - Disponueshmëria e kompjuterëve, aksesit të internetit dhe shërbimeve *broadband* në shkolla për zhvillimin e trajnimit të mësuesve dhe përdorimit të përmbajtjes së mësimit elektronik (*e-learning*).	MITIK AKSHI Sektori privat Ministritë e linjës

Modelet e financimit	Krijimi i instrumenteve financiare për zhvillimin e *broadband* me kosto sa më të ulët.	-Identifikimi dhe përcaktimi i kostos për implementimin e zgjidhjeve teknologjike për të përmbushur objektivat. - Identifikimi i të gjitha burimeve të mundshme të fondeve, duke përfshirë grantet, kredi, te ardhurat e pritshme (future revenue streams) dhe madje edhe partneret në kontribute- dhe krijimi i një plani financiar për vendin. - Konsiderimi i krijimit të Rrjetit Kombëtar Broadband përmes PPP subjekt i detyrimeve për akses të hapur.	Komisioni për Zhvillimin e *Broadband* MITIK MF AKEP

SHTOJCA 2: KOSTIMI I PJESSHËM AFATMESËM PËR ZBATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË *BROADBANDIT*

Grupi. Sigurimi i aksesit broadband për administratën publike përmes GovNET dhe shërbimet elektronike përmes portalit unik

000/lekë

Projekti	**Sigurimi i aksesit *broadband* me shpejtësi 100Mbit/s për administratën publike**		
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	**Viti 2013**	**Viti 2014**	**Viti 2015**
	10,000	15,000	15,000
Projekti	**Përmirësimi/zgjerimi i infrastrukturës Cloud Computing**		
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	**Viti 2013**	**Viti 2014**	**Viti 2015**
	32,600	37,000	58,200
Projekti	**Ofrimi i shërbimeve e-government interaktive nëpërmjet e-albania.al**		
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	**Viti 2013**	**Viti 2014**	**Viti 2015**
(IPA 2012)	136,600	160,200	102,700
Jashtëbuxhetore		100,000	300,000

Projekti IPA. *"Mbështetje për Ministrin e Inovacionit dhe TIK, si dhe për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, me synim zhvillimin e infrastrukturës së IT-së dhe të shërbimeve të qeverisjes elektronike në Shqipëri"*	
Aktivitetet	
1.	Zhvillimi *i Information Interchange Layer* të qeverisjes elektronike (zgjidhja dhe arkitektura ESB).
2.	Sistemi i protokollimit dhe arkivimit të dokumenteve shkresore EDRMS (Electronic Document and Record Management System).
3.	Ridizenjimi i portalit qeveritar shumëfunksional *e-albania*
4.	Zhvillimi i shërbimeve elektronike C2G: - Aplikimi për Maturën Shtetërore - Aplikimi për patentë
Investimi total	2,28 milionë euro
Afati implementimit	18 muaj, 2012-2013

Grupi. Përmirësimi i shërbimeve TIK në sistemin arsimor sipas parashikimeve në PBA-në 2013-2015

Produkti K	**Blerja e programeve informatike për shërbimet në MASH, DAR/ZA**		
	Viti 2013	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	20,000	5,000	5,000

Produkti A	**Instalim dhe shërbim interneti në shkollat e arsimit 9-vjeçar**		
Numri i shkollave të instaluara 400	**Viti 2013**	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	134,115	80,000	60,000
Produkti A	**Biblioteka shkollore të krijuara sipas standardeve**		
Numri i nxënësve përfitues: 118760	**Viti 2013**	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	25,000	25,000	25,000
Produkti I	**Blerja pajisje informatike për krijim laboratorë IT**		
Numri i laboratorëve: 56	**Viti 2013**	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	50,000	80,000	100,000
Produkti A	**Shkolla të pajisura me laboratorë shkencore**		
	Viti 2013	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	45,000	50,000	50,000
Produkti A	**Laboratorë IT në shkollat AMP**		
	Viti 2013	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	57,000	60,000	65,000
Produkti N	**Blerje pajisje laboratori IT për pajisjen e klasave të ndërtuara dhe rindërtuara**		
	Viti 2013	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	20,742	14,518	20,000

Kostimi për realizimin e aksesit broadband të internetit në 1945 shkolla (planifikimi afatmesëm sipas llogaritjeve të MASH)

Interneti 8Mbit/s			
Nr. godina	**Kosto/muaj**	**Totali/muaj**	**Totali/vit**
1945	11000	21,395,000 lekë	256,740,000 lekë

Kostimi për ofrimin e shërbimit internet në klasa bazuar në numrin e klasave (Planifikimi afatgjatë sipas llogaritjeve të MASH-it)

Infrastruktura			
Zgjidhja	**Kosto mesatare/klase**	**Nr. klasa**	**totali**
Varianti me sistem menaxhimi në distancë	58,387 lekë	21652	1,264,195,324 lekë
Varianti pa sistem menaxhimi në distancë	22,131 lekë	21652	479,169,586 lekë

Grupi. Përmirësimi i shërbimeve në sistemin shëndetësor përmes TIK sipas parashikimeve në PBA-në 2013-2015

000 lekë

Produkti C	**Blerja e pajisjeve të zyrës dhe kompjuterike për MSH dhe institucionet e tjera**		
	Viti 2013	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	1,800	1,000	4,500
Produkti K	**Pajisje mobilimi, kompjuterike, elektrike teknologjike**		
	Viti 2013	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	50,000	0	10,000
Produkti A	**Blerje programi pajisje kompjuterike**		
	Viti 2013	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	0	0	230,000
Projekti 04242: Projekti i informatizimit të sistemit shëndetësor E-Health			
Produkti P	**Blerje programi pajisje kompjuterike**		
	Viti 2013	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	0	0	230,000
Produkti S	**Programi dhe pajisje kompjuterike**		
	Viti 2013	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	1,044,900	695,120	0

Grupi. Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve publike përmes TIK sipas parashikimeve në PBA-në 2013-2015

1. Sistemet e Ministrisë së Brendshme

000 lekë

Produkti E	**Rrjet funksional kompjuterik për të gjithë sektorët sipas niveleve**		
	Viti 2013	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	35,180	37,680	39,300
Produkti G	**Platforma elektronike e menaxhimit te burimeve njerëzore, menaxhimi i sistemit dhe prodhimi i raporteve HR**		
	Viti 2013	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	7,596	7,927	8,269
Produkti A			
	Viti 2013	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)			

2. Përmirësimi i shërbimeve elektronike të e-taksë dhe prezantimi i m-service sipas parashikimeve në PBA-në 2013-2015

000 lekë

Produkti C	**Informim dhe publicitet për shërbimet ATQ**		
	Viti 2013	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	5,400	5,400	5,400
Produkti E	**ATQ e pajisur me baze logjistike dhe kompjuterike funksionale**		
	Viti 2013	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	39,900	39,960	46,460
Produkti G	**Drejtori rajonale tatimore të rikonstruktuara**		
	Viti 2013	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	20,400	49,700	0
Produkti K	**Sistem funksional i transferimit të të dhënave nga pajisjet fiskale**		
	Viti 2013	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	4,300	9,600	9,600
Produkti L	**Sistem i deklarimit të të ardhurave personale**		
	Viti 2013	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	20,000	20,000	23,600
Produkti M	**Sistem për digjitalizimin e arkivave ATQ**		
	Viti 2013	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	0	10,850	38,600
Produkti N	**Sistem njoftimi përditësimi për tatimpaguesit**		
	Viti 2013	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	15,000	4,940	13,540
Produkti K	**Platformë e teknologjisë se informacionit e mirëmbajtur**		
	Viti 2013	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	15,150	14,400	14,050

3. Infrastruktura TIK e MPCSSHB dhe shërbimet e e-punësimit sipas parashikimeve në PBA-në 2013-2015

000 lekë

Produkti F	**Përmirësimi i infrastrukturës TI**		
	Viti 2013	**Viti 2014**	**Viti 2015**

Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	11,975	14,365	18,730
Produkti G	**Përmirësimi i sistemeve TI**		
	Viti 2013	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Parashikimet e shpenzimeve (000 lekë)	12,250	14,565	14,060

Shtojca 3

Modelet e financimit të *broadband* në Europë

Në lidhje me zhvillimin e *broadband*, vendet e Europës kanë zgjedhur alternativa të ndryshme për të siguruar ndërhyrjen/fonde publike në financimin e *broadband*. Bazuar në dokumentin e Komisionit Europian të vitit 2012, mbi planet kombëtare *broadband*, më poshtë po paraqesim eksperiencën e disa vendeve të Europës:

- **Portugalia** ka investuar fonde nga Plani Europian Ekonomik i Rimëkëmbjes (EERP) për të shpërndarë NGA në 140 komuna. Ofertuesve fitues iu kërkua të lidhnin të paktën 50% të popullsisë në secilën komunë me një shpejtësi minimale prej 40 Mbps (doënload) brenda 2 viteve. Portugalia, gjithashtu, ka krijuar një linjë kredie prej 800 milionë eurosh e hapur për të gjithë investitorët e NGA.
- **Mbretëria e Bashkuar** rezervoi 530 milionë paund në vitin 2010 për të mbyllur boshllëqet lidhur me mbulimin me rrjete/shërbime *broadband* dhe për të siguruar që ofrimi i shërbimeve *broadband* me shpejtësi të madhe të arrijë të paktën në 90% të familjeve.
- **Austria dhe Spanja** po planifikojnë riinvestim të pjesshëm të të ardhurave nga ankandi i digjital dividentit. Suedia e ka bërë tashmë këtë gjë.
- **Franca** ka përcaktuar një program kombëtar gjithëpërfshirës për shtrirjen e *broadband* me shpejtësi të lartë i cili përbëhet nga një kombinim instrumentesh financimi. Një komponent është shuma prej 900 milionë eurosh parashikuar për subvencione të projekteve të autoriteteve lokale për të shtrirë NGA. Teknologjitë e pranueshme do të jenë kryesisht FTTB/H, por, gjithashtu, edhe rrjetet e bakrit të përmirësuara, si dhe zgjidhje ndihmëse me teknologjinë pa tela (radio). Një tjetër shumë prej 1 bilion eurosh është rezervuar për kredi për investitorët privatë që kërkojnë të shpërndajnë NGA dhe një komponent i tretë është shuma deri në 100 milionë euro për kërkim e zhvillim të zgjidhjeve satelitore me shpejtësi të lartë.
- **Estonia, Latvia dhe Lituania** përdorin fonde strukturore për të implementuar një model, ku investimet e sektorit publik ose një kombinim i investimeve publike me ato private, zgjerojnë shtrirjen e fibrave optike në zonat rurale dhe vendosin pikat e aksesit që shërbejnë si një bazë për përhapjen e rrjeteve të aksesit nga operatorët privatë.
- **Suedia** ka krijuar një "fond tubacionesh" për të mbështetur shtrirjen e infrastrukturës pasive si një bazë për shpërndarjen më pas të shërbimeve *broadband*.
- Në **Itali**, Projekti Kombëtar Strategjik për *broadband* me shpejtësi të lartë do të mbështetet si nga sektori publik ashtu edhe ai privat; të dy këto projekte dhe plani kombëtar *broadband* do të kërkojnë marrëveshje të veçanta midis rajoneve, provincave autonome, autoriteteve lokale dhe administratës qendrore. Implementimi i këtij projekti pritet të fillojë me një alokim të parë prej rreth 0.5 bilionë eurosh të fondeve strukturore të rezervuara për projekte rajonale nga Kalabria, Pulia, Sicilia, Basilikata, Sardenja dhe Molisë.
- **Finlanda** këshillon komunat se si të përfshijnë subjekte të veçanta në shpërndarjen e NGA në zonat ku nuk shërbehen nga tregu i komunikimeve elektronike, si p.sh. një sipërmarrje e përbashkët e shumë komunave ose në partneritet me operatorët privatë.

Burimi. Dokumenti i Grupit të Punës së Komisionit Europian mbi Planet Kombëtare *Broadband* - SËG(2012) 68 final/2